

GAQO BUSHAKA

BIBLIOTEKA E


SHTETIT

854 - 32  
13.96.

GJERGJ KASTNER



# KARROCA GAZMORE



85H-32  
B96.

# KARROCA GAZMORE

T R E G I M E

455

~~4862~~



SHTEPIA E SHKOLLËS  
BOTONJËSE NAIM FRASHËRI

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

# DIKUSH U FUT NE PYLL

Kur doli nga shtëbia, Cenit i shkuan të ngjethura në trup. Bënte ftohtë. Dëbora kishte mbuluar, si me një napë të bardhë e të ftohtë, malet, drunjtë e lartë qhe gjithë fshatin. Në dëborën që shtronte udkjet e ngushta të fshatit, dukeshin një mori gjurmësh të çrregullta njerëzish e kafshësh. Përtrej xhadesë, te rrëza e malit, ngrihej një shtëllungë vigane tymi e flake, që tretej shpejt në gjinë e kulluar të qie llit kaltërosh. Nga larg vinte zëri i fuqishëm i traktorit, që shkulte trur, gje të mëdha, shumë të mocme. Ceni ferkoi duart, shtrëngoi më fort pas qafe shallin e gjatë përej leshi ngjyrë vjollce dhe nisi të vraponë aridëj nga dukej zjarri. Kooperativistët po digjnir atje shkurre e gjem-

ba për të hapur tokë të re. Ceni, djali më i shkathët në shkollë, vraponte duke shtrënguar në dorë bishtin e një sopate të vogël. Kur doli në majë të bregut, shokët që e panë, i thirrën:

— Ej Cen, hajde shpejt! Të paska zënë gjumi.

Ceni vrapoi tatëpjetë bregut, për nga shokët; ata po u ndihmonin kooperativistëve për të hapur toka të reja. Në mes të shokëve të vet, Ceni dalloi dhe mësuesin kujdestar, Nexhatin.

— Mirëmëngjezi! — u tha Ceni me një frysme.

— Mirëmëngjezi! — u dëgjua nga të katër anët.

— Cen, pse u vonove? — e pyeti mësuesi.

— Më ishte thyer bishti i sopatës dhe i bëra një të ri, shoku mësues.

— Të lumtë, paske bërë bisht të mirë!

— Kur të mbarosh së preri hunjtë, na thirrë t'i marrim së bashku. Shiko zgjidh ca të drejtë, se na duhen për të rrrethuar kopshtin e shkollës.

— Do të mundohem, shoku mësues. Sa mirë do të duket kur t'i lyejmë edhe me gëllqere të bardhë si dëbora.

— Mund të shkoj dhe unë me Cenin? — ju drejtua Loni mësuesit.

— Pastaj; tē mbarojmë njëherë këtë punë që kemi këtu, — i tha mësuesi.

Ndërsa Ceni u nis për në pyll, mësuesi i mblodhi nxënësit pranë një trungu tē madh që sapo e kishte shkulur traktori, dhe u tha:

— Ja, shikoni: duke i numëruar rrathët e këtij trungu, gjejmë se sa vjeç është.

— Tridhjetë vjeç, — thirri Teuta.

— Tamam, — pohoi mësuesi. — Rrathët e trungjeve na ndihmojnë gjithashtu edhe për tē gjetur pikat e horizontit. Nga kjo anë është veriu, sepse rrathët janë më tē shpeshtë, kurse nga ana e kundërt është jugu. Djathtas është lindja, ndërsa majtas perëndimi.

Fëmijët filluan tē prekin me gishta vijat mavi tē rrathëve tē trungut. Ndërkhohë, Ceni ishte futur në pyll. Frynte erë; ajo përplasej me forcë mbi lisat e gjatë e tē zhveshur. Në pyll filloj tē ndihej goditja e sëpatës së Cenit. Pasi punoi ndonjë orë, Ceni mblodhi ca ashkla dhe ndezi një zjarr pranë një trungu tē thatë tē rrëzuar nga era. Flaka e kuqe ja ngrohu duart. Nxori nga xhepi bukën dhe e vuri tē thekej. Pasi nxori një copë djathë tē butë si gjalpë dhe filloj tē hante, në pyll hyri një njeri i vesur me një xhup tē trashë, vende-vende tē çjerrë. Ai po afrohej, dhe Ceni vuri re një ftyrë tē verdhë, mbuluar me qime tē zeza e tē

dendura. Gjunjët e pantallonave i kishte të arnuar keq. Në sup mbante një sopatë. I ngrohte duart me frymë dhe pastaj i fërkonte. Nuk qe më shumë se pesë çape larg zjarrit, kur tha:

— E, mor djalë, paske ndezur zjarr?

— Po, — tha Ceni.

— Mirë ke bërë, është ftohtë. Po pse paske dalë kaq herët në pyll?

— Dua të pres ca shufra për kopshtin e shkollës, se na futen bagëtia brenda.

— Të ngrohem edhe unë ca.

— Urdhëro, — i tha Ceni dhe i liroi pak vend.

— E kini të madh kopshtin e shkollës? — pyeti i panjohuri.

— Posi, që nga kroi e gjer te ai ledhi aty përtej. Dhe e di sa mirë e mbjellim!

— Ç’mbillni në kopsht?

— Kemi mbjellë pemë, misër, zarzavate... Na, kaq të mëdhenj u bënë shalqinjtë vjet! — tha Ceni duke hapur duart. — Apo nuk e kishin zemrën flakë... flakë të kuqe. E pse të mos bëhen? Apo s'u kemi sjellë pleh të mirë që nga shpellat e malit, ku verojnë bagëtia!

— Po, po, ai është pleh i mirë, — mërmëriti i panjohuri.

— Po ty, nga të kemi? — e pyeti Ceni dhe e vështroi drejt në sy të panjohurin, i cili si-

kur u trondit nga pyetja e papritur e vogëlushit.

— Jam nga fshati S., — tha ai dhe, koku-lur, vazhdoi të ngrohte duart mbi flakë. — Dua të pres ca furka të mira për pjergullën, por s'po gjej. I bëj tani në dimër, se në behar nuk na jenë punët.

Ceni dëgjonte dhe përtypente bukën në hesh-tje. I panjohuri heshti dhe ja nguli sytë me lakmi, si një ujk i uritur, copës së bukës që kishte Ceni në dorë.

Ceni, sikur ta kishte kuptuar, ja zgjati:

— Merre, unë hëngra dhe në shtëpi.


Burri e mori copën e bukës pa thënë as faleminderit dhe, sa të mbyllësh e të hapësh sytë, e gjelltiti të gjithë. Por e pa që gaboi, dhe i tha Cenit duke qeshur.

— Ika shpejt, pa vënë gjë në gojë. Na mbytën punët.

«Ksh të jetë ky?» — mendonte Ceni me vete. «Fshati S. ka pyllin e vet, pastaj... bu-ka...»

— Po të duash edhe më bukë, shkoj të të sjell, se e kam afër shtëpinë.

— Jo! Jo! — picërrroi sytë i trembur i panjohuri, ndërsa nga larg dëgjohej kënga e fshatarëve dhe e nxënësve, që punonin së bashku.



- Ç'bëhet ashtu në fshat?
- Po hapin tokë të re. Po ju, nuk hapni?
- Posi, shumë madje, shumë. Ama, jukini fshat të bukur, — vazhdoi i panjohuri. — Sa më pëlqen! Ajo shtëpia e bardhë dhe e bukur atje, mos është e sekretarit të partisë?
- E atij është, — gënjeu Ceni.
- Po kryetari i këshillit, pranë tij e ka shtëpinë?
- Po. Ja, te ajo shtëpia atje, që ka atë gurin e madh pranë derës, — gënjeu përsëri Ceni.

— Çudi, tamam si në fshatin tonë.

I panjohuri nuk foli më. Futi dorën në xhepin e grisur dhe nxori që andej një cigare. Pastaj u kërrus për ta ndezur në prushin e kuq.

Ceni e vërejti me kujdes të panjohurin. Ai kishte ca flokë të gjatë e të zez, që futeshin thellë nën jakën e xhupit. Ashtu i përkulur, dukej tamam si ndonjë bishë e egër. Dhe, Ceni nisi të arësyetonte me vete.

«Jo, jo, ky nuk është nga fshati S.; ky flet ndryshe nga ata. Ky njeri ka ardhur të bëjë ndonjë të keqe në fshatin tonë. Është diversant!» — Kur solli ndërmend këtë fjalë, u zverdh. «Pse pyeti për sekretarin e partisë dhe për kryetarin e këshillit? Mos kërkon t'i vrasë? Mos vallë do që të lërë pa baba Yllin, Sparta-

kun? Por... unë nuk do ta lë! Po sikur të mos jetë diversant? Sa do të tallet Nasi me mua pastaj! Duhet të hetoj edhe më».

I panjohuri vazhdonte të thithte cigaretin, që i dridhej midis gishtërinjve të verdhë.

— Kanë duhan të mirë këto cigaret «Partizani», — foli i panjohuri. — Do ta provosh një?

— Faleminderit, nuk e pi.

— Si të duash.

Ai nxori nga xhepi një letër dhe shënoi diçka me laps. Si e futi letrën në xhep, ju kthyte Cenit.

— Shënoj ditët e punës; gjer tani kam bërrë 300 ditë pune.

Ceni tundi kokën në shenjë miratimi, dhe flokët e zez, të ndarë me vizë anash, i ranë mbi ballë. Nishani i zi i dukej tani më qartë në faqen e zbetë. Ai mendonte në heshtje se si ta pyeste të panjohurin në ishte vërtet nga fshati S., apo jo. Atë çast, në kokë i erdhi një mendim, që i ndriçoi fytyrën, ashtu siç ndriçon dielli natyrën pas shiut. Fshtarët e fshatit S. kishin festë pas dy ditësh, përvjetorin e formimit të çetës së parë partizane të krahanës. Mësues Nexhati i kishte lajmëruar fëmijët e shkollës se do të shkonin dhe ata të jepnin një çfaqe

për partizanët e dikurshëm. Prandaj e pyeti të panjohurin:

— Më duket se në fshatin tuaj po përgatiten për festë. Ç’do të festohet?

I panjohuri thithi gjatë cigaren dhe nisi të fliste ngadalë duke u përtypur:

— Festohet dhjetëvjetori i formimit të kooperativës bujqësore. Po të duash, hajde dhe ti, do të jetë shumë bukur.

«Popooo, ç’gjenjeshtë!» — tha me vete Ceni. «Po kooperativa në fshatin S. u formua në një kohë me kooperativën tonë, para pesë vjetësh. Ky është diversant, diversant!» — dhe lëvizi nga vendi, sikur ta kishte pickuar diçka.

— Ç’pate? — e pyeti i panjohuri.

Më dogji një copë prush, s’ka gjë, s’ka gjë, — tha Ceni dhe vështroi nga lindja.

— Bobo sa paska vajtur dielli! — thirri befas Ceni. — M'u bë shumë vonë, dhe shokët nuk po vijnë. Siç duket, kanë harruar udhën. Dëgjo, mik! A më bën një nder?

— Ç’nder?

— Ja, më ruaj pak këto shufrat sa të gjej shokët, që të vijnë t’i marrin. Do të marr dhe ca patate e t’i pjekim bashkë në zjarr. I ha patatet, se unë i ha shumë.

I panjohuri u lëpi:

— Mirë, shko, po shpejt, ama, se kam punë.

Ceni u nis me vrap dhe u fsheh pas një grumbulli drurësh. Vërejti të panjohurin, që u ngrit dhe u nis me shpejtësi për nga mali, duke i rënë pyllit përmes.

— Ky është tamam diversant! — mërmëriti Ceni dhe u nis fluturimthi për në postën e kufirit. Te dera gjeti ushtar Samiun, që kishte një qen të madh leshtor. Ushtar Samiu vinte shpeshherë në fshat. U ndihmonte fshatarëve në punë ose kërcente vallen e Rajcës në mbrëmjet e défrimit. Ai kishte shkuar dhe në shkollë dhe u kishte folur për kapjen e shkelësve të kufirit. Samiu ishte gjithnjë i qeshur.

— Ej, Sami, prit, prit pak! — i thirri Ceni.

Kur ju afrua pranë, u ngrit në majë të gishtérinjve dhe i pëshpëriti diçka në vesh. Samiu s'e bëri të gjatë. Bashkë me dy shokë dhe me qenin, u nis me vrap. Shokët muarën anën e malit, kurse Samiu, Ceni dhe qeni u futën në pyll.

— Këndeje, këndeje iku, — thoshte Ceni.

Të dy vrapuan pas qenit, të cilin Samiu mezi e mbante me një têrkuzë të gjatë e të fortë. Qeni ndiqte gjurmët e të panjohurit.

Ceni vraponte pas qenit dhe ushtarit. Gjaku, që i lëvrinte me shpejtësi në deje, ja kishte bërë fytyrën si lulë kuqe. Vrapuan kështu një copëherë, gjersa qeni u ndal, u ul në gjunjë

·dhe filloj të rrëshqiste ngadalë mbi dëborë, drejt një shpelle, hyrja e së cilës dukej si një gojë e madhe e zezë që qëndron gjithnjë hapur. Atë çast, një krismë çau ajrin e ftohtë. Samiu u lëkund dhe ra përmbyss. Një njollë gjaku u duk mbi dëborë. Ceni u mundua ta ngrinte, ndërsa qeni vazhdoi të shkonte përpara duke u maskuar, sikur të ishte njeri. Nga shpeilla doli dikush.

— Ńshtë ai, ai! — mërmëriti Ceni, me lot zemërimi në sy, duke i zbërthyer gjimnastior-kën ushtar Samiut. Befas, qeni u hodh mbi të si rrufe.

— Mbyte! Mbyte! — thërriste Ceni duke shtrënguar grushtat e vegjël, dhe vrapoi t'i shkonte në ndihmë. Filloj përleshja. Ceni pa se nga dora e të panjohurit ra mbi dëborë një gjë e zezë. Këmbët e duart i qenë mpirë nga të ftohtët. Ceni e rrëmbeu pistoletin dhe shënoi mbi diversantin. Atë çast, fytyra e djalit dukej tamam burrërore. Ndërkohë, erdhën dy ushtarët e tjerë dhe një grup fshatarësh të armatosur. Ceni i pa, u buzëqeshi dhe u ul i lodhur, po fitimtar, mbi dëborën e butë e të ftohtë.

# KRUSHOLT

Atë ditë babai u kthye nga kuvendi i burrave me fytyrë të vrarë. Pa hyrë mirë në shtëpi, i thirri nënës:

— Grua, më bëj gati bukën; do të shkoj gjer në qytet të marr pleh kimik për kooperativën. Sonte mos më prit, se nuk arrij dot të kthehem, do të fle atje.

Unë dhe Neta, motra ime, dolëm në shkallë. Babai e pa Netën një copë herë, sikur nuk e kishte parë kurrë dhe, kur nëna solli bukën, i tha:

— Tani je e lirë. Dhashë fjalën në kuvendin e burrave se fejesën tënde me Mersinin e quaj të prishur.

Neta zbriti shkallët fluturimthi, si një zogëzë që del nga kafazi në ajrin e lirë, dhe ju hodh babait në qafë. Ai e puthi, i lëmoi flokët e verdhë dhe iku pa e kthyer kokën. Siç duket, nuk deshi që ne t'ja shihnim lotët që i rrohdën nga gëzimi. Nëna mbeti si e shtangur mu në mes të oborrit, pa guxuar të fliste. Neta, që ju hodh në qafë, e solli në vete.

- Avash, se më dërmove, moj leshprerë.
- Jam e lumtur, nënë!
- Ashtu qofsh! — i tha ajo duke fshirë sytë me cepin e përparses.

Pas nënës e kisha radhën unë të duroja përqafimet e Netës. Nuk e kisha parë kurrë aq të gëzuar.

— Nesër Neta do të të blejë një palë kë-pucë të reja, — më tha duke më mbërthyer komçen e trikos.

- Neta, a të të them një fjalë?
- Folë, xhan i motrës.
- Do që të më përqafosh edhe një herë?
- Po, — buzëqeshi ajo.

— Atëhere premtomë se do të më blesh edhe një këmishë të re, se atë tjetrën e grisa dje duke luajtur me top.

Motra më pushtoi përsëri, dhe unë fitova këshfu një këmishë të re.

Kur u futa në dhomë, mendova me vete:

«Pse babai nuk e bëri këtë më përpara? Ka një vit e shkreta Netë që punon natë e ditë e qan. S'e do të fejuarin, s'e do! Pastaj, kush është ky njeri? As Neta, as nëna, as unë s'e kemi parë kurrë. Vetëm babai tha: Është djalë i mirë! — dhe kaq.»

E mbaj mend dhe tani shpullën që hëngra nga babai kur i thashë: «Baba, Neta nuk do të fejohet. Ndaje! Pse e bën të qajë kot? Kur qan ajo, më vjen dhe mua të qaj!»

Nuk e zgjata më tepër, se duheshin zgjidhur detyrat e aritmetikës për të nesërmen. Problema qe e vështirë. S'dilte që s'dilte, se nuk e kisha krejt te ajo mendjen. Kur e mbarova dhe pashë se përfundimi më kishte dalë tamam si në fund të librit, thirra me sa fuqi pata:

— E zgjidha, e zgjidha!

— Mos zgjidhe tërkuzën ku kam nderur rrobat, mor i paudhë? — thirri nëna që nga dhoma e zjarrit.

— Jo, moj nënë, jo, zgjidha problemën që kisha për detyrë shtëpie.

— Problemën? Mirë bëre; tani hajde të hamë bukë.

U ulëm në sofër. Neta, që mezi hante dy kafshata, llufiti plot dy pjata me supë. Kur po mbaronim së ngrëni, dikush trokiti në portë

mengadalë. Nëna e hapi, dhe brenda hynë shtatë burra. Njërin e njoha: ishte mblesi i Netës, ai Lili, që i kishte sytë gjithmonë të skuqur nga rakia.

Neta, kur e pa, u bë dyllë e verdhë.

— Si u ngryse, moj zonjë e shtëpisë? As bujrum nuk po na thua, — i tha mblesi nënës, që po rrinte si e hutuar.

— Urdhëroni! — i tha nëna me zë të mekur.

— Ku e ke të zotin e shtëpisë?

— Ka shkuar gjer në qytet.

Ata nuk pyetën më, po shkuan në dhomë. Neta deshi të dilte, po mblesi e kapi fort përsupi duke i thënë:

— Ku vete, moj shqerrkë? Ne për ty kemi ardhur.

— Unë s'kam punë me ju!

— Po kemi ne me ty. Mos kujto se yt atë e dha me gjithë mend fjalën sot në kuvendin e burrave? Ai foli ashtu sa përtu hedhur të tjerëve hi syve; ne nuk e prishim krushqinë.

— Gënjen, grabitës! — i thirrai unë që nga qoshja ku isha struktur.

— Pusho, ti, mi hamami! — ulëriti mblesi.

— Hajde, se nuk kemi kohë; bëjeni gati vajzën, se do ta marrim që sonte. Në shtëpi

na presin dasmorët me raki e me mish të pjetkur.

— Pa qenë burri, unë nuk e jap vajzën,  
— u tha nëna. Pastaj, ajo nuk e do të fejuarin.  
— Po paratë, i deshët? — u zgërdhi mblessi.

— Merrini paratë, ja ku i kini, — u tha Neta duke hedhur te këmbët e tyre një tufë kartmonedhash të reja, që i nxori nga sënduqi.

Mblesi i pa me vërejtje kartmonedhat e shpërndara në dyshemenë e dhomës dhe tha:

— Ato nuk na duhen më; bëje gati vajzën dhe mos e zgjat, ndryshe i lajmë hesapet me këtë, — dhe i tregoi nënës pushkën e shkurtër që kishte me vete.

— Unë vdes, dhe nuk vij me ju! — foli e inatosur Neta.

Ajo nuk do të kishte shkuar me të vërtetë, po forca e gjashtë burrave e mposhti. Nuk durova dot, dhe dola duke qarë nga dhoma. «Ah, sikur të kisha mundësi t'i lajmëroja shokët e të shikonin pastaj këta se ku do të futeshin. Vetëm nuk jam i zoti ta mbroj motrën, që po ma rrëmbejnë».

Kur dola në divan, nga brenda u dëgjua një zë i trashë burri:

— Mos ka ndonjë dalje tjetër e na ikën ai laneti?

— Mos u bëj merak, Mersin, dalje tjetër nuk ka, ndërsa nga porta s'del dot njeri, ti e di.

Vërtet nuk dilja dot. Nga pas portës, ulur në oborr, ruanin dy burra. U mbylla në dhomën ku flnim, dhe rashë përmbyss mbi jastëk. Ç'të bëja? Edhe sikur të bërtisja, nuk do të më dëgjonte njeri, se shtëpitë ishin larg. Le që «krushqit» do të ma mbyllnin gojën. M'u kujtua diçka tjetër. Fshiva lotët me kurrizin e dorës dhe u futa në dollapin e madh. Atje rrinte varur pushka e babait. Sa herë e kisha fshirë atë pushkë bashkë me babanë! Me të kisha qëlluar vetëm një herë, atëherë kur erdhi në fshat drita elektrike. Po, ama, ma kishte mbajtur babai, ndërsa unë vetëm kisha tërhequr këmbëzën. Tani do të provoj të shtie vetë. E dija se me tri të shtëna pushke mblidhei gjithë fshati. Ky ishte sinjali i alarmit. E mora pushkën me duar që më dridheshin. I dija të gjitha pjesët e saja, dija dhe ta mbushja, po, të them të drejtën, kisha frikë të shtija. A do ta mbaja dot? Koha s'priste. I futa fishekët te gusha e pushkës dhe e vendosa këtë në dritaren e vogël të dhomës. E lidha fort pas hekurit të dritares, që të mos më shpëtonte nga dora, mbylla systë dhe shtiva...

Një krismë çau ajrin, dhe një dritë ndriçoi për një çast errësirën e natës.



— S'qenka dhe fort e zorshme, — thashë me vete; djersa më shkonte çurkë, dhe shtiva edhe dy herë të tjera.

Në dhomë ja befën «krushqit», si të çmendur.

— Kush të tha të shtiesh, kush? — ulëriti mblesi.

Sa i shëmtuar që dukej në atë çast!

— Përse zemëroheni, zoti Seit? — i thashë ngadalë. — A nuk po martoj motrën sonte? Gjithmonë kemi shtënë me pushkë në dasma. Meqë nuk është baba, shtiva unë.

— Na... këlysh bushtre, na... se na more më qafë!

Nga pëllëmbët e rënda, sytë më nxorën xixa. Rashë mbi dysheme. Nëna u sul nga unë duke thirrur.

— Shpejt të ikim! — ja pat mblesi.

Po një zë i fortë e ngriu në vend:

— Mos u nxito, o matrapaz i fëlliqur! Sot vajzat e gratë tonë kanë zot Partinë, gjithë popullin!

Ishte sekretari i partisë. Pas tij kishin ardhur shumë burra të armatosur. Me ta ishte edhe Ylli, shoku im.

Sekretari i partisë u hodhi nga një sy krushqve të tjerë, që kishin varur kryet, dhe erdhi pranë meje. Më ngriti dhe më fshiu me

shami njollat e gjakut. Unë e përqafova dhe pëshpërita:

— Sa mirë, sa mirë që erdhët shpejt, ndryshe...

— Të lumtë, Sokol, sot shtive tamam në shenjë!

Pas pak, shtëpia u zbraz. Sekretari i partisë dhe fshatarët i vunë përpara të lidhur «krushqit» e paftuar.

# **AMANETI I PARTIZANIT TE PLAGOSUR**

Në fshatin tim, së bashku me vieshtën, vijnë dhe shirat, ca shira të mërzitshme, që s'kanë të sosur. Ato vijnë bashkë me ca re të zeza, që duken sikur mbështeten në kreshtat e errëta të maleve. Petritin, fqinjin tim, e mërzisin shumë këto ditë me shi, sepse nuk del dot dhe rri vetëm në atë kasollen e vet të ftohtë, që pikon nga të gjitha anët. Si i vdiq dhe gjyshi, mbeti fillikat. Megjithëse nuk i kishte mbushur të katërmëbëdhjetat, i dukej vetja burrë. Nuk bridhte më pas zogjve, po këndonte ca këngë prekëse, që kushedi se ku i kishte mësuar. Fshatarët e dëgjonin dhe pëshpërisnin:

— Eh, i gjori jetim!

Një ditë, ndërsa Petriti po mundohej të piqte një kalli misri, u dëgjuan që nga larg uturima e një kaçatori, plasje bombash dhe zhurma e një mitralozi, që sa vinte e afrohej. Deshi të dilte, po shiu vazhdonte të binte. Shau nga inati dhe e mbylli prapë derën, që kërciti me një kërkëllimë ngjethëse. Era e tërbuar dukej sikur do ta rrëmbente atë me gjithë kasolle dhe do ta flakte diku larg. Po Petriti nuk u trembej as erës, as italianëve, që ishin shtruar këmbëkryq në fshat. Nisi të përtypte kallinë e fortë gjysmë të pjekur dhe shikonte shiun e tejdukshëm, që, sa binte në tokë, formonte rrëke të shpejta, që vareshin poshtë bregut me një zhurmë monotone.

Befas, dera u hap dhe, së bashku me ulërimën e erës, hyri dhe një zë i mekur. Petriti u drodh; te pragu i derës po qëndronte një burrë me rroba të çjerra, tërë baltë, i verdhë si limoni. Ishte shtrirë përmbyss dhe rënkonte. Petriti e zuri nga krahët dhe e tërhoqi brenda.

— Qenka partizan! — tha me vete Petriti kur pa kapelen me yll. — Do të jetë plagosur keq, po si ta shpëtoj? Si?

Vuri në zjarr ca karthia të thata, që i kish-te bërë gati për darkë, dhe filloi t'i frynte zja-

rrit. Një flakë ngjyrë vjollce nisi të bubullonte nga to.

Partizani nisi përsëri të rënkonte. Nxehësia e zjarrit e përmendi. U përpoq të ngrihej, po Petriti e ndaloi.

— Mos luaj, këtu nuk vijnë italianët, se nuk ka as pula, as vezë.

— Si të quajnë, djalosh? — i tha me gjysmë zëri i plagosuri.

— Petrit.

— I ke parë partizanët këtej, Petrit?

— Për të parë s'i kam parë, po kam dëgjuar se janë diku përtej atij pyllit të madh.

— I do partizanët ti, Petrit?

— Mezi pres të vijnë e t'u vënë drunë këtyre breshkamanëve.

— Ti e ke në dorë që fashistët të ikin sa më parë nga fshati.

— Unë!?

— Po, ti. Partizanët që janë përtej atij pylli të madh, duhet ta fillojnë sulmin nesër, së bashku me çetat e tjera. Unë isha nisur të lajmëroja komisarin për orën e sulmit, se çetat duhet të sulmojnë të gjitha njëheresh, po u plagosa dhe nuk mund të shkoj; kam humbur shumë gjak dhe nuk më mbajnë këmbët.

— Shkoj unë, — tha Petriti, dhe sytë i shkëlqyen. — Në ç'orë duhet të fillojë sulmi?

— Në orën pesë të mëngjezit. Ki kujdes, se italianët nuk lënë njeri të dalë nga fshati. Vonesa jote prish shumë punë.

— Mos u bëj merak, di unë si t'ua hedh atyre. Ti rri këtu dhe ngrohu. Ja ku po i vë dhe ca dru zjarrit.

— Dëgjo, — i foli përsëri partizani, — parrulla është: «Breshka ra në lak». Kurse kundërparrulla: «Tani do ta mbysim». Po nuk t'u përgjegjën kështu, mos u thuaj asgjë.

I shtrënguan dorën njëri-tjetrit, dhe Petriti fluturoi nëpër shi. Vraponte dhe vështronte me kujdes nëpër kthesat e monopatit. Në të dalë të fshatit, atje ku kodra e veshur me drurë lisi pritet nga përroi, Petriti shtangu në vend. Dy ushtarë fashistë i dolën përpara. U mundua të dredhonte, po njëri nga ushtarët i drejtoi pushkën dhe i thirri:

— Mos luaj!

Shuli i pushkës kërciti, dhe ushtarët ju afroan Petritit.

— Ku vete? — e pyeti njëri syresh.

— Më ka humbur një dhi dhe më duhet ta gjej. Është dhia manare e kryeplakut. Më lini ta gjej, zotërinj, se do të më kalbë në dru po s'e gjeta.

Njëri nga ushtarët i vuri në kurriz një torbë të rëndë duke i thënë:



— Tani hajde me ne gjer te mulliri, pastaj shko ku të duash.

— Zotërinj, më lini. Dhinë mund ta hajë ndonjë ujk ose mund të shkasë e të bjerë nga ndonjë buzë. Ju e shihni që vendi është i lagur. Kryeplaku mund t'ja japë ndojë tjetri tu-fën e dhive, e ç'të bëj unë i ziu pastaj?

— Shko përpara, marrsh! — ju çorën të dy njëherësh dhe e shtynë me kondakët e pushkëve.

Petriti u nis përpara me torbën e rëndë plumb mbi kurrizin e vet të njomë dhe, nga zemërimi, nisi të qante në heshtje. Lotët i përziheshin me pikat e shiut të rrëmbyeshëm dhe i rrokulliseshin nëpër faqe. Ekte dhe vriste mendjen si t'u shpëtonte fashistëve. Bëri njëherë sikur i ra të fikët, po ushtarët e goditën, dhe ai, me gjysmë shpirti, u ngrit. U mundua të ecte me vrap që të arrinte sa më shpejt, po mulliri ishte larg.

«E gjeta!» — tha me vete kur pa lumin që gjarpëronte poshtë bregut. Kërkoi me sy që nga lart pellgun e thellë dhe, pasi u afrua, lëshoi torbën dhe u hodh nënë të kokëposhtë.

Plumbat e ushtarëve ngritën përpjetë stërkala uji, po Petritin nuk e prekën. Ai doli me not në breg dhe vrapoi nëpër monopatet e ngushta. Kur hyri në pyll, yjet mezi dukeshin.

Drita e argjendtë e hënës futej nëpërmjet degëve të mbushura me fletë ngjyrë bakri. Ndërsa vraponte, drizat e ferrat i gërvishnin mishin e njomë. Po ai s'ndalej; porosia e partizanit duhej çuar në vend!

Aty, në të dalë të pyllit, fuqitë ju prenë. I dukej sikur drurët e gjatë të lisave hidhnin valle mbi kokën e tij.

«Edhe pak, edhe pak!» — i jepte zemër vetes duke lëvizur ngadalë buzët e trashura nga lodhja.

Më në fund, u këput e ra, po me këmbë e me duar u afrua te një burim i turbulluar nga shiu dhe futi kokën në ujët e akullt.

U ngrit përsëri dhe eci një copë udhë gjersa doli nga pylli. Nxori nga gjiri fyellin, i fryu një herë me tërë fuqinë që i kishte mbetur, dhe ra i alivanosur. Zëri i fyellit tërhoqi vemendjen e rojes partizane që vrojtonte mbi majën e një shkëmbi. Disa partizanë vrapuan për nga djali dhe e morën në krahë. Fërkimet e ngrohtësia e zjarrit i dhanë pak fuqi.

— Komisarin, dua komisarin! — foli djali me gjysmë zëri.

Partizani që mbante në dorë një kuti konserve plot me çaj të ëmbël për Petritin, thirri:

— Shoku komisar! Shoku komisar!

Komisari, që po shënonte diçka me laps mbi një hartë, vrapoi pranë djalit, që hapi systë dhe u ngrit i trembur.

— Mos u tremb djalosh, ne jemi partizanë. Unë jam komisari.

— Breshka ra në lak.

— Tani do ta mbysim, — u përgjegj komisari.

Atëhere Petriti, me zë të ulët e duke pirë çajin e nxeh të që i përvëlonte buzët, tregoi gjithshka. Më në fund, e pyeti komisarin:

— A kam ardhur në kohë, shoku komisar?

— Të lumtë, djalosh! Ti je tamam partizan. Ne kemi kohë të përgatitemi.

Në agim, sa po erdhi ora e caktuar, partizanët nisën sulmin. Me ta vraponte dhe Petriti duke thirrur:

— Urra... Urra... Para partizan!  
Fashistët ua mbathën. Fshati u çlirua.

Petriti vrapoi te partizani i plagosur; bashkë me të shkuan dhe ca partizanë të tjerë. Ai po qëndronte në pozicion luftimi pranë kasolles.

— Ja ku është, — thirri i gjëzuar Petriti dhe ju hodh në qafë.

Partizanët e përqafuan me radhë shokun e vet.

Çeta u nis për të ndjekur këmba-këmbës armikun. Fshatarët i përcollën me dashuri partizanët çlirimtarë. Pranë komisarit ecte kryelartë një partizan i vogël me pushkë në krahë e me fyellin në dorë: Ishte Petriti...

# KARROCA GAZMORE

Po të mos kishte qenë Luani, ne do të ishim turpëruar, dhe hajde pastaj t'i dilje përpara Fatmirit, kujdestarit të klasës VII B. Ai mburrej e ngrefosej si gjel kot së koti, e jo më tani që kishte ca të drejtë. Ja si qe puna: Në fshatin tonë, mu aty ku lumi dilte nga kthesa, po ndërtohej një hidrocentral i vogël, që do t'u jepte dritë tri fshatrave të kooperativës sonë të zmadhur. Kur na e tregoi këtë mësuësja, u hodhëm përpjetë nga gëzimi. Si të mos gëzoheshim? Do të na vinte drita, do të dëgjoni në radio emisionin tonë të pionerit. Brigadierja e mjelëseve, Ana, na tha se edhe lopët do t'i milnim me korent.

Në mbledhjen e çetës dhamë fjalën se

edhe ne, pionierët, do të ndihmonim që në fshat të vinte drita elektrike sa më parë. I nxitur nga shokët e klasës, që s'më linin rehat, u ngri-ta dhe fola:

— Ne zotohemi se do të mbledhim gjëra të vjetra prej bakri dhe alumini, aq sa do të duhet për ta çuar korentin në të gjitha fshatrat e kooperativës sonë. Për këtë i shpallim garë klasës VII B.

Entuziazmi i shokëve nuk u përbajt më; shpërthyen duartrokitje.

— Mirë, mirë, — thanë ata të klasës tjeter, — po mos u lëvdoni kaq. shumë. Qesh mirë ai që qesh i fundit.

Gjatë asaj jave, secili nga ne mbloodi në-për shtëpi dhe rrugica çdo gjë të vjetër prej bakri dhe alumini që gjeti. Kur i sollëm në shkollë në fund të javës, pamë se klasa tjeter na e kishte kaluar shumë.

C'të bënë?

Secili nga ne hartonte plane, bënte propozime, dhe këto ja pasonim njëri-tjetrit në copa letre në orën e mësimit, po më kot.

Një natë, kur ishim mbledhur te porta e shtëpisë së Petros, vjen me vrapi Sokoli. Ju nuk e njihni Sokolin. Është i vetmi në klasë që e mban kokën gjithnjë të qethur tullë. Atij i vjen ndoresh për çdo gjë, saqë thotë se mund

të ndërtojë dhe raketa po të ketë vegla. Këtu e tepron një çikë. Kur nxiton në të folur, i merrt goja më shumë se zakonisht.

— Mi... mi... mirëmbrëma! —na tha ai.

— Mirëmbrëma! — ju përgjegjëm ne.

— K... kë... kam gjetur një ve... ve... vend, ku do të gjejmë bakër sssha të duash.

— Ku? — e pyetëm të gjithë njëherësh.

— Ja, ja, te ajo shsh... shpella e madhe mbi burimin e xh... xh... xha Lazoz. Ja, k... k... kam gjetur këtë te hy... hyrja e saj, — dhe na tregoi një copë bakri në formë katërkëndëshi kënddrejtë, të gjatë sa një rigë.

— Të nisemi që tani, — u hodha unë. —

Ti, Ndreko, gjej një fener, pa shkrepse kam unë. Kurse unë me Luanin po shkojmë të gjejmë ndonjë kazëm ose sqepar të vjetër.

Petriti dhe Sokoli pritën atje. Ne ikëm me vrap dhe pas pak u kthyem. Pesë veta dhe qeni i Luanit, Bubka, gjashtë, u nisëm për te shpella. Në fshat kishte rënë qetësia. Duke ecur njëri pas tjetrit, arritëm te shpella. Ajo ishte një shpellë e çuditshme, e madhe sa dy dhoma të mëdha bashkë. Atje kishim hyrë vetëm një herë ditën, kurse natën kurrë. Sa herë na kishin treguar gjyshet tona gjëra të tmerrshme për atë shpellë!

Sokoli mbante në dorë fenerin, dhe drita e

verdhë ndriçonte çdo skutë të shpellës. Ne e ndoqëm pas. Kur po arrinim në fund të shpellës, Bubka u hodh përpjetë. Neve na ngriu gjaku. Sokolit i shpëtoi feneri. Luani ngriti kazmën, unë shtrëngova sqeparin, kurse Petriti u ngjesh pas murit. Bubka na kishte trembur kot. Ishte hedhur përpjetë vetëm që të zinte një lakuriq nate. Luani i bërtiti, dhe qeni e lëshoi.

Filluam punën. Kërkuam sa u lodhëm, po nuk gjetëm gjë. Kushedi kush e kishte hedhur atë rrip bakri, që na lodhi kot. Sokoli u hutua fare; nuk nxirte dot fjalë të saktë nga goja, po vetëm mërmëriste:

— Çu... çudi e madhe!

Të lodhur e të mërzitur, u kthyem në shtëpitë tona. Hëna, si një drapër i hollë, vezullonte në qiell.

Në mëngjez u treguam gjithshka shokëve të klasës. U mërzitëm aq shumë, sa nuk na bëhej as të shkonim në shkollë. Megjithatë, asnjëri nga ne nuk mungonte. Detyrat i bënim në rregull.

Një javë para se të mbaronte gara jonë, mësuesi i matematikës na tha:

— Sot pasdite do të vijë xha Nasi të na tregojë për luftën e madhe që bënë partizanët te gryka e fshatit tonë. Xha Nasi ka marrë pjesë vetë në atë betejë të ashpër ku u vranë dhjetra armiq.

Neve na pëlqenin shumë tregimet nga Lufta nacionalçlirimtare, prandaj shkuam që të gjithë atë pasdite. Erdhi, madje, edhe Luani, me gjithëse ishte i sëmurë nga bajamet. Kur mbaroi xha Nasi, dhe ne e përcollëm me dashuri, Luani na tha me gjysmë zëri:

— E dëgjuat me vëmendje xha Nasin?  
— Po, qe tregim interesant.  
— Po kur tha që partizanët u hodhën si luanë mbi italianët dhe i groposën me gjithë ç'kishin, madje dhe me kazanin plot me makarona, që s'arritën t'i hanin? E dëgjuat kur tha se rrëzuan edhe një aeroplan atje tej, në pyll?

— Po mirë, ç'del nga kjo?  
— Ja se ç'del: ne do të gërmojmë te vendi që tregoi Xha Nasi, dhe do të gjejmë boll gjëra prej bakri dhe alumini.

Luanit i pjell mendja. E përqafova fort. Çudi si nuk na kishte rënë ndërmend puna e aeroplanit. Sa herë kishim luajtur symbyllazi atje!

Të nesërmen, pasi dolëm nga shkolla, ja nisëm punës.

Kazmat ndiqnin njëra-tjetrën. Asnjëri nuk fliste, ndonëse të gjithëve na mundonte një pyetje: «A do të gjejmë gjë?»

Atë çast, si një lajm i madh gazmor, u dëgjua zëri i Sokolit:

— E gjigj... gjeta!

U grumbulluam të gjithë pranë tij. Kishte gjetur një bidon të madh alumini. U përqafuam të gjithë duke thirrur:

— Forca, forca se do të gjejmë dhe të tjera.

I mblodhëm mbeturinat e kaçatorit dhe i radhitëm mbi bar. Kur dielli, si një mollë e madhe e kuqe, po fshihej pas malit, na erdhën në ndihmë edhe shokët e tjerë të klasës. Punuam me kujdes pesë ditë. Ditën e gjashtë morrëm nga dy gomarë, e ngarkuam thesarin tonë dhe e çuam në oborrin e shkollës.

Aty nga mesdita u bë peshimi te fusha e volejbollit. Së fundi, drejtori i shkollës, i cili kishte kohë që po peshonte, na tha:


— Ju lumtë, garën e fitoi klasa VII A.

Neve na qeshi fytyra.

Fatmiri, kujdestari i klasës së mundur, erdhi pranë meje dhe më dha dorën.

— Ju lumtë! Ju punuat më shumë dhe fituat. Vetëm dua t'ju them një gjë: te vendi që gërmuat, themi të mbjellim ca rrënjet qershi. Si mendoni ju?

— E ke menduar shumë mirë, Fatmir, nuk na ra hiç ndërmend.



Atë çast erdhi xha Stavri me karrocë. E mbushëm dëngëza me metale. Sokoli mbërtheu mirë një flamur të kuq mu në mes të karrocës, dhe gjithshka ishte gati. Hipëm në karrocë dhe u nisëm për në qytet, të ndjekur nga Bubka i Luanit, që s'na u nda gjersa e hipëm në karrocë.

Shokët na përshëndetën me dorë. Kur zbritëm në fushë, Fatmiri ja nisi i pari këngës:

**Në njërën dorë kazmën  
Atdheun ndërtojmë,  
Në tjetrën dorë pushkën  
Fitoret ne mbrojmë.**

# KULLAE BEUT

Mbi qytet ra mbrëmja, dhe rrugët llamburitën nga dritat e neonit. Maqina me rrula ngjiste lart tullat silikate, dhe ne, dorë më dorë, i dërgonim atje ku muratorët ngrinin murin e katit të dytë të shtëpisë që po ndërtohej në lagje me punë vullnetare. Ne këndonim mbi skelat prej hekuri, dhe kënga jonë dukej sikur shtrinte krahët e fluturonte mbi qytetin që gumëzhinte. Së bashku me muratorët punonte dhe im atë. Pas pak, zhurma e maqinës që ngjiste tullat lart, pushoi. Ne të gjithë shikuam poshtë, nga brigadier Vasili, që i thërriste babaït dhe i thoshte:

— Shoku Rako, për sonte mjafton. Fëmijët do të shkojnë në shkollë nesër.

— Po ne i kemi përgatitur me kohë de-tyrat, — folëm ne njëzëri.

— Mirë, mirë, po duhet të çlodheni. Nesër hajdeni prapë, o pëllumbat e mi.

Kënga nisi përsëri, dhe ne, me turfullimë, nisëm të zbrisnim nga skelat e hekurta, me gjithëse brigadieri vazhdonte të na thërriste nga poshtë:

— Ngadalë, fëmijë, ngadalë, se mos na gërvishet ndonjëri.

— Mos u bëj merak, xha Vasil, ne nuk gërvishemë.

Pastaj, nga të gjitha anët, u dëgjuan:

— Natën e mirë, xha Vasil, natën e mi-rië... Nesër do të vijmë përsëri.

— Gjumë të ëmbël, bijtë e mi, mirë ardhshi nesër! — përshëndeste plaku duke buzëqeshur.

Të gjithë u nisëm grumbull për në shtëpi-në time, se, kur të kthehej, babai im do të na tregonte historinë e jetës së vet.

Ai nuk vonoi shumë dhe, kur hyri në dhomë, fëmijët u shtynë dhe i bënë vend në mes tyre.

— E, u lodhët ndopak? — pyeti babai.

— U lodhëm ca, xha Rako, por, ama, jemi të gjëzuar, se do ta mbajmë fjalën e dhënë. Si thua ti, xha Rako, do ta mbarojmë dot shtëpinë më 21 prill?

— Besoj se po.  
— Nesër do të punojmë më me vrull.  
— Po, bijtë e mi. Juve ju sjell gëzim puna, se punoni për vete, për shokët tuaj, kurse ne dikur... Eeeh! Ta dini ç'kanë hequr të parët tuaj në vogëli për një kothere bukë! Ju duhet të mos i harroni sakrificat që kanë bërë ata.

Dhe babai, që fliste ngadalë, ja nisi:

— Edhe babai im punonte murator. Zanatin e kishte mësuar nga një mjeshtër gollo-bordas, që nuk dihej nga humbi andej nga Turqia, ku kishte shkuar të kërkonte punë. Me-që në fshatin tonë nuk kishte shkollë, dhe ne ishim të këputur sa më s'bëhej, që në moshën 12 vjeç babai më mori me vete. Që atëhere e gjersa dola partizan, nuk më qeshi buza; me babanë shkonim fshat më fshat e qytet më qytet që të kërkonim punë, po shumë herë nuk gjenim dhe ktheheshim në shtëpi të lodhur e të mërzitur, me bark e qese bosh. Një ditë, babanë dhe pesë mjeshtra të tjerë muratorë nga fshatrat fqinj i thirri beu i fshatit tonë. Ai don-te të ndërtonte një shtëpi të re mbi një breg, prej nga fshati dhe xhadeja dukeshin si në pëllëmbë të dorës. Usta Jani, njëri nga mjeshtrat muratorë, që këndonte gjithnjë këngën: filloi i

## I ziu që kur kam lerë, Hyzmeqar derë më derë . . .

pari të gërmonte për të bërë themelet. Pastaj ja nisën dhe të tjerët. Në fillim unë shikoja, pastaj nisa t'u sillja ujë të ftohtë nga kroi dhe t'u afroja pranë themelit gurët që do të mbannin shtëpinë e re. Atë ditë u bë sebep një shi i mallëkuar, që na e mbushi plot themelin e s'na linte të punonim. Usta Jani me babanë, të futur gjer në brez në ujin e turbullt, diçka matnin me një spango të gjatë. Unë vazhdoja të sillja gurë dhe lëpija pikat e shiut, që më vareshin mbi buzë. Që tej u dëgjua zëri i usta Janit:

«Mengadalë, mor djalë, se je i vogël dhe nuk bën mirë të ngresh gurë të mëdhenj. Kjo e flamosur varfëri do t'ju lërë me cen që në moshë të njomë.»

«Hajt, hajt, se forcohet», — thërriste qehajai duke fshirë cepat e mustaqeve të varura.

Një ditë, usta Jani nuk doli në punë. E zunë një palë ethe, saqë dridhej i téri si purteka. Mundohej të mbulohej me kashtë, po më kot. E ku e ngrohte dot kashta trupin e tij të bërë kallkan. E mbuluam me xhaketat tona téré arna dhe nisëm përsëri punën. Në vend të usta Janit punuam ne. Babai punonte lart, në skelejn e drunjtë, pa pushuar. Shtëpia duhej mba-

ruar sa më shpejt. Befas, nga qelli i nxirë filloj të binte përsëri shi. Tre muratorë të tjerë dhe unë zbritëm poshtë për të përgatitur gurët e skalitur. Atë çast u dëgjua një kërcitje dërrash dhe një zhurmë. U ngritëm menjëherë dhe, për një çast, mbeta si i ngrirë.

«Rako!» — thirrën muratorët.

«Baba! . . .» — thira unë.

Po nuk u dëgjua asnjë zë. Ai rrinte shtrire, me fytyrën nga qelli sterrë. Binte shi . . .

Kështu mbeta jetim. Pas ca ditësh, doli në punë dhe usta Jani. Punonim bashkë. Tani çdo gjë më dukej e zymtë, e shpëlarë. Punoja pa folur, se në shtëpi duhej bukë dhe bukën, në vend të babait, duhej ta nxirrja unë. Një ditë prej ditësh, shtëpia e re e beut u mbarua. Mua më paguan më pak nga të tjerët, se isha i vogël, po muratorët ma plotësuan nga të vetat.

Pas ca ditësh, në shtëpinë e re të beut u bë një darkë e madhe, ndërsa fshati vuante për një dorë misër.

Mendova për gjakun e babait, për atë gjak që u derdh në themelet e asaj kulle, dhe më mbuloi të tërin një valë zemërimi. Padashur, vajta andej, ndërsa këmbët mezi më mbanin nga të pangrënët.

Në oborr pasqë Norën, shërbëtoren, që ndiqte nga pas Selfionin, vajzën e beut, që t'i



jepte petulla tē ngrohta me mjaltë. Më nē fund e zuri Vajza e përkëdhelur përplaste këmbët e thërriste: «Po tē duash, më gjej një kalë që tē fluturojë, pa ti ha petullat!»

Atëhere ndjeva një dhembje nē stomakun e zbrazët.

Brenda, dhoma ziente nga mysafirët e trullosur. Thërrisin, qeshnin, këndonin, po askujt s'i shkoi mendja te ata që e kishin ndërtuar atë shtëpi. Kur u afrova te dritarja, vura re se si një i dehur i hodhi një gotë verë mu nē fytyrë një shërbëtori; këtij i dogjën sytë. Ndenja ashtu një copë herë. Zemërimi që më vlonte përbrenda, arriti kulmin. Kapa një gur dhe e vërvita me urrejtje nē dritare.

Xhami plasi pinë-pinë. Ahengu pushoi, dhe përjashta vrapiuan dy qehallarët. Njëri më qëlloi me kërbaç, duke thënë:

«Hajt, lipsu tutje, laro! Ngordhsh si yt atë!»

Ika duke qarë.

Shkova përsëri nē atë shtëpi pas pesë vjetësh. Beu kishte shtruar përsëri një gosti tē madhe pér një kope fashistësh, po këtë radhë isha unë me shokët e mi partizanë që i nxora përjashta beun dhe fashistët...

# FREDI NISET PER NE MAL

— Ditën e mirë, nënë! — thirri Fredi me atë zërin e vet të hollë, si cicërimë zogu, ndërsa po zbriste nga shkallët e gurta, të shtëpisë.

— Udhë të mbarë, bir, dhe ki mendjen se mos rrëzohesh gjékundi!

— Mos ki merak, moj nënë. Unë jam mësuar tanimë!

Fredi shtyu me forcë portën e madhe e të rëndë, që mbështetej në dy shtylla të forta lisi, mu atje ku mbaronte kalldrëmi i oborrit, dhe doli në udhë.

Udha dukej e qetë. Fshatarët, pasi kishin nxjerrë bagëtinë, qenë futur përsëri brenda. Vetëm Agimi, elektriçisti i kooperativës, po montonte, te një shtyllë e lartë, një izolator me

kokë të bardhë. Kishte dy muaj që kishte ardhur në fshat drita elektrike, dhe tani dëgjo-heshin radiot nga të katër anët.

- Mirëmëngjezi, xhaxhi Agim!
- Mirëmëngjezi, o alpinist i vogël! As të dielën nuk bën pushim?
- Po ditët e tjera kam shkollë. Ditën e mirë!

— Ditën e mirë! — ju përgjegj Agimi duke tundur dorën ku mbante shtrënguar pincat.

Fredi, si çdo të diel, edhe atë ditë u nis për në mal. Atje mblidhite insekte të ndryshme të rralla, që gjenden pranë drurëve të rrëzuar, nën kërpudha, dhe flutura krahëqendisura, me ngjyra të mrekullueshme, që thithin nektarin e ëmbël të luleve. Insektet i kapte me një rrjetë të vogël me bisht druri, i shponte më gjilpërë me kokë dhe i vendoste në një kuti të madhe të mbuluar me xham. Fredi kishte mbushur disa kuti të tillë dhe, në fund të vtitit, do t'ja jepte mësueses së botanikës, dhuratë për shkollën.

Nisi t'i ngjitej malit të fshatit, ndërsa dielli po fshihej pas reve ngjyrë plumbi, që sa vinin e shtoheshin, duke u grumbulluar pranë njëra-tjetrës. Vjeshta apo kishte nisur të hynë. Një erë e lehtë ja përkëdhelte Fredit flokët e verdhë si grurë i pjekur. Kurorat e gjelbëra të

pemëve kishin filluar të zverdheshin. Ngjitja të lodh, po, sa më lart të ngjitesh, aq më të lehtë e ndjen veten. Rrëzë një trungu të rrëzuar, mbushur me milingona, që venin e vinin në dy rrjeshta të drejta, me ushqim në gojë, Fredi pa një insekt të çuditshëm.

«Kurrë gjer më sot nuk kam parë insekt të tillë, — tha me vete i habitur dhe u ul ta vërente me kujdes. — Sa do të gëzohet mësues-ja kur t'ja çoj!»

Qe me të vërtetë një insekt i çuditshëm, tamam si një gjemb ngjyrë balte; ecte duke zvarritur ato këmbkat e vogla e të holla, si mustaqe misri. Insekti i çuditshëm sikur e ndjeu rrezikun dhe nisi të zvarritej më me shpejtësi, po gjilpëra e Fredit ju ngul në trup dhe, ashtu siç qe, u vendos në kutinë me xham.

— Më duket se po ecën mbarë; — mërmëriti Fredi, — do të kem një koleksion të mirë, — dhe hodhi në krah trastën ku mbante kutinë dhe bukën me gjalpë.

Tani fshati dukej shumë i vogël. Fredi kishte ecur mjaft pas shkëmbinjve. U mundua të dallonte shkollën.

— Eh, sa e vogël duket që këndeja, si ajo shtëpia prej kartoni të ngjyrosur, me të cilën luan Nina, — tha Fredi duke qeshur. Ai nisi

përsëri të kacavirrej me kujdes nëpër shkëmbinjtë e thepisur e të mbuluar me myshqe. Ekte dhe vështronte me vëmendje rrëzën e një shkëmbi, që i ngjante kokës së një plaku me mjekër pak të zgjatur. Aty kishte mbirë një lule e bukur me petale të kaltëra. Nektarin e ëmbël si mjalti, përzier me vesë, po e thithët me ëndje një flutur tabake. Fredi la mënjanë trastën dhe nisi të ngjitej te maja e shkëmbit pa u ndjerë, me rrjetën në dorë. Atë çast ju bë sikur dëgjoi rënkimë të shkurtëra, që vinin nga ana tjetër e shkëmbit. Rrënkimet u bënë më të forta, po pastaj nuk u djenë më. Fredi u zbeh në fytyrë dhe zbriti nga shkëmbi duke e lënë fluturën tabake të thithët nektarin. Pas shkëmbit, disa metra poshtë, pa një milore, që kishte rënë me faqe mbështetur mbi barin e hollë e të rrallë që mbin pranë shkëmbinje. Në syrin e deles shndriste si margaritar një pikë loti.

«Bobo, si qenka dërmuar! — tha me vete Fredi — Fatmiri, bariu i kooperativës, kujdesej shumë për delet, po kjo, me siguri, është ndarë nga shoqet; ka humbur udhën dhe ka rënë poshtë. Kështu e pëson kushdo që ndahet nga shokët!» Po delja duhej ndihmuar, se mund të ngordhët. Ishte nga tufa që kooperativistët tanë do t'ja falnin një kooperative të zonave të

thella malore. Tufa duhej tē shkonte atje tamam sa ç'e kishin dhënë fjalën. «Duhet çuar patjetër te veterineri», — arësyetoit Fredi shpejt e shpejt me vete. Po si tē zbriste? Vendiqë thikë. E si ta ngjiste pastaj lart delen? Po delja duhej shpëtar. Pasi u mendua një çast, fytyra i mori një pamje burrërore. Nxori nga mezi türkuzën e hollë që mbante me vete përtu ngjitur nëpër shkëmbinj, e rrrotulloi te trungu i një peme, buzë greminës, dhe e lëshoi më dysh poshtë. Filloi zbritja. I dukej sikur zemra do t'i shkallmonte gjoksin, aq fort i rrihte. Duart i shtrëngonte fort pas türkuzës së punuar me lesh tē ashpër dhije. Muskujt e tij tē fortë e mbanin përmrekulli peshën e trupit tē varur. Fredi bënte gjimnastikë çdo ditë, ndaj e urdhëronte me lehtësi çdo pjesë tē trupit tē vet.

— Më në fund, zbrita! — pëshpëriti i loddhur dhe u afrua pranë deles.

Te koka dhe pranë brinjëve tē deles ai dalloi njolla gjaku. Ajo s'rënkonte më. Fredi e përkëdheli, i fshiu gjakun me shami, po delja s'tundej, sadoqë ai i fliste sikur ajo tē ishtenjeri.

— Të ketë ngordhur vallë? — pëshpëriti ai me gjysmë zëri. Në çast, ju kujtua diçka. Kërkoi nëpër xhepe dhe gjeti një copëz pasqy-

rë, vende-vende të gërvishtur. E fshiu mirë e mirë dhe ja afroi deles pranë hundës. Dalëngadalë, pasqyra u vesh me avull.

— Është gjallë, gjallë! — bërtiti i gëzuar.

E puthi delen dhe e tërroqi ngadalë gjer pranë litarit që mbështetëj në faqen e pjerrët të shkëmbit. Nxori rripin e mezit dhe e lidhi. Te rripi rrrotulloi têrkuzën dhe filloi ta têrhiqte ngadalë, pastaj nisi të ngjitej vetë duke i ngulur mirë gishtërinjtë e këmbëve në gropëzat e vogla të faqes së shkëmbit. Djersa i pikonte. Kur arriti lart, e zgjidhi delen shpejt e shpejt dhe u mundua ta merrte në duar.

— Oh, që s'e mbaj dot të shkretën! Eh, të kisha shokët, — foli i hidhëruar, po shpresën nuk e humbi. Ai qe pionier, dhe pionierët nuk têrhiqen kurrë para vështirësive. E lidhi përsëri delen, u ul në gjunjë dhe e mori në shpinë. Pastaj u ngrit me vështirësi dhe eci përpara.

Retë përplaseshin njëra me tjetrën dhe zigzaget e shndritshme të vetëtimave shtrihe-shin në fushën e qiellit. Mali oshëtinte nga gjëmimi i bubullimave. Një shi i rrëmbyer nisi vrapin që nga maja e malit. Fredi ecte me kujdes, duke u mbajtur pas shkurreve, që i gjakosnin duart e vogla. Të ftohtët ju fut mu në



palcë, po ai s'ndahej. Për një çast, u bë sikur dëgjoi zërat e shokëve, që i jepnin zemër: «Mbahu Fred, të lumtë, na nderove! Pastaj i doli përpara fytyra e merakosur e bariut, që ndoshta kërkonte delen. Fredi eci plot dy orë. Më në fund, arriti te një portë e lyer me bojë të gjelbër. Portën ja hapi një grua e gjatë, veshur me bluzë të bardhë. Infermierja, e habitur, pa thënë asnjë fjalë, i rrëmbeu delen nga krahët.

— Mjekun! Shpejt mjekun! — thirri ajo.

Fredi u fut brenda i lehtësuar, po me zemër të ngrirë.

«A do të shpëtojë delja, vallë?»

Pas pak, Fredi pa veterinerin, i cili, si veshi dorezat e operacionit, i mbante duart përpjetë, sikur të qe dorëzuar. Ai filloi të punonte në barkun e hapur të deles. Në dhomë dëgjohet vetëm zhurma e ujit ku zienin gjilpërat.

Fredi priste në koridor, pas derës gjysmë të hapur, dhe ishte shumë i shqetësuar.

Më në fund, veterineri doli nga dhoma. Duke i përkëdhelur flokët e qullur, ai i tha Fredit:

— Të lumtë, kështu veprojnë pionierët e vërtetë! Delja shpëtoi!

Atë çast, nga sytë e Fredit u rrukullisën

dy pika lot; ai po qante nga gëzimi. U përshëndet me veterinerin, si dhe me gruan e gjatë veshur me bluzë të bardhë dhe pastaj fluturoi tërë gaz nëpër rrugët e ngushta të fshatit, pa pyetur për shiun që vazhdonte të derdhej nga qielli.

# DREDHJA E ILIRIT

Muzgu kishte rënë mbi lisat e lartë, mbi shtëpitë dhe mbi grurin e gjelbër nëpër ara. Iliri po pritte te pjergulla nga dy degë të varura; i donte për kecin pullali, që kishte vrarë këmbën. Në këtë e sipër dëgjoi zërin e gjyshit.

- Ilir, o Ilir! I fute bagëtitë brenda?
- I futa, gjysh, i futa.
- Po tani, ku vete, nuk e sheh që u err?
- Do të vete të marr dhe gomarin.
- Mbylle portën dhe lëre gomarin të kullosë.
- Pse ta lëmë jashtë, gjysh?
- Po nuk e sheh që e kemi të paktë zahirenë? Apo të na ngordhin edhe ato dy dhi

që kemi dhe të mbetemi pa një pikë qumësht!  
Ai beu i mallkuar mezi na la një dorë bar...

— Mos u mërzit, do t'ja marrin partizanët, gjysh!

— More Ilir, po mos bërtit, se na dëgjon njeri. Hajde, mbyllë portën dhe futu brenda.

Ndërsa Iliri po i vinte portës llozin e madh të drunjtë, nga fundi i fshatit u dëgjuan ca pushkë, po pastaj ra përsëri heshtja.

Kur hyri Iliri brenda, nëna e kishte shtruar sofrën. Ai u sul pranë gjyshit dhe nisi të hante atë çikë përshesh me qumësht. Kur mbaroi, i tha nënës:

— Ka ndonjë gjë tjetër, moj nënë?

— S'ka bir, s'ka, po bjerë e fli tanë.

Në portë u dëgjuan të trokitura të lehta. Gjyshi u ngrit dhe shkoi të hapte portën. Iliri dëgjoi se gjyshi po fliste në oborr me dikë me një fill zëri. Pastaj pa gjyshin të futej brenda dhe, pas tij, një burrë shtatlartë. Në kapele ai kishte një yll të kuq. Në krahë mbante një djalosh me fytyrë të zverdhur, pa ndjenja.

— Mirë se ju gjeta! — tha partizani.

— Mirë se erdhe! — i thanë njëzëri nëna dhe Iliri.

— Vëre këtu shokun, — foli gjyshi; — ngadalë se mos i lëndosh plagët.

— E kanë plagosur keq të poshtërit! — tha partizani.

— Po si ju ndodhi, mor bir? — e pyeti gjyshi.

— Mua, Petritin, — partizani tregoi me dorë nga shoku i plagosur, — dhe Fatmirin na caktuan të vrismi në qytet një spiun të fashisteve. Spiunin e qëruam në mes të pazarit, por, kur po ktheheshim në çetë, na qëlluan pas shpine ca ballistë dhe plagosën rëndë Petritin. Shyqyr që shtëpija juaj qe pranë rrugës, se as unë nuk do të ngjitesha më lart me shokun në krah.

Gjyshi e pyeti përsëri:

— Po shoku tjetër, Fatmiri, ku vajti? Mos e zunë ballistët?

— Jo, gjysh, s'biem kollaj në dorë ne. Ai shkoi të marrë një mushkë te një miku i tij. Duhet ta çojmë Petritin që sonte te mjeku, se mund të na vdesë në duar. Kur të vijë Fatmiri me mushkën, do të këlthasë tri herë si kuku-vajkë. Duhet të kemi kujdes, gjysh, se ballistët mund të vijnë këtu; shtëpia është në rrugë.

Gjyshi s'foli, vetëm tundi ngadalë kokën thinjoshe.

Iliri sikur i përpinte fjalët e partizanit dhe, herë-herë, shikonte fytyrën e zbetë të të plagosurit, i cili dukej sikur nuk merrte frymë.

Sapo partizani filloi të dridhte një cigare nga kutia e gjyshit, në portë u dëgjuan të trokitura të forta kondakësh.

— Shpejt, ngjitni të plagosurin në tavan, ngjitu dhe ti me të! — i tha gjyshi partizanit, ndërsa vetë doli duke thirrur:

— Daleni, more, daleni, se më thyet portën! Kush jeni?

— Hape shpejt!

Gjyshi e hapi portën ngadalë, dhe në shtëpi u futën tetë ballistë.

— Vetëm je? — pyeti kryetari i tyre.

— Me nusen dhe me nipin.

— Nuk ke njeri tjetër brenda?

— Jo, — i tha përsëri gjyshi.

— Shiko, po doli ndryshe, kjo të pret, — dhe i drejtoi revolverin. Gjyshit nuk ja bëri bef syri.

Ballistët u turrën brenda, u hodhën një sy të katër qosheve të shtëpisë dhe u ulën këmbëkryq pranë zjarrit, si të ishin në shtëpinë e vet.

— Na kanë shpëtuar për qime nja tre partizanë sonte, — tha kryetari i tyre. — Këtu rrotull do të jenë, po nuk po i gjejmë dot.

Gjyshi rrotullonte në dorë cigaren e trashë dhe sytë nuk i shqiste nga flaka ngjyrë vjollce e zjarrit bubulak.

Nga jashtë u dëgjua tri herë një zë si i kuvajkës. Gjyshi dhe Iliri të trembur, vështruan njëri tjetrin në sy. Ilirit i buçitën në vesh fjalët e partizanit: «Duhet ta çojmë Petritin që sonte te mjeku, se mund të na vdesë në duar...»

Ndërsa ballistët po pinin duhan dhe bisedonin me zë të lartë, Iliri doli nga dhoma e zjarrit dhe zuri të kërkonte fenerin. E gjeti varur te një gozhdë; pastaj mori shkrepsen dhe doli përjashta. Hëna, herë dilte, herë fshihej në retë e rralla që lundronin në qzell si copa njollash të zeza.

Iliri u nis me vrap për nga bregu ku kishte lënë gomarin të kulloste. Bënte ftohtë, po Iliri nuk e ndjente. Mendjen e djalit katërmbëdhjetëvjeçar e kishte pushtuar vetëm një mendim: Të nxirrte nga shtëpia partizanët.

Në një lëndinë të vogël, atje te bregu, Iliri pa gomarin, që po kulloste. Ju afrua dhe filloi ta përkëdhelte nga qafa. Kafsha e njoihu dhe mbështeti kokën pas këmishës së tij. Iliri ndezi fenerin dhe, me një copë tërkuzë, ja vari gomarit në qafë. Pastaj u nis me vrap për në shtëpi. Aq shpejt vraponte, sa dukej sikur nuk i takonin këmbët në tokë. Hyri me një frymë në oborr, shtyu ngadalë portën dhe pastaj u fut ngadalë në dhomën e zjarrit.

Pas pak, njëri nga ballistët, që kishte dajë për nevojë, hyri brenda me rrëmbim duke thirrur:

— Një dritë në breg, një dritë në breg!

Ballistët dhe gjyshi brofën në këmbë dhe dolën në dritaret e divanit. Vërtet, në breg dukej një dritë që lëvizte ngadalë dhe tundej.

— Oburrani! — thirri si i çmendur komandanti i ballistëve. — Do të jenë ata, partizanët! Oburrani, t'i zëmë, qentë!

Të tetë burrat u sulën si ujqër të uritur.

— Shpejt, shpejt, zbrit! — i thirri gjyshi partizanit.

Ai, së bashku me gjyshin, e zbritën Petritin e plagosur. Iliri u ndihmonte dhe buzëqeshte.

— Po ti, pse qesh? — i tha me të butë partizani.

— Qesh se tetë burra të armatosur po vrapijnë pas një gomari.

— Pas një gomari?! — thirri gjyshi, i habitur.

— Po.

Dhe Iliri u tregoi për dredhinë. Partizani i shtrëngoi dorën, e puthi dhe i fali një yll të kuq. Iliri e mori dhe e futi në gji. Partizani dhe gjyshi e çuan Petritin te Fatmiri, që i priste. Fatmiri e kishte vulosur me bar zilen e mush-



kës dhe këmbët ja kishte lidhur me lecka të vjetra, që të mos dëgjohej zhurma e patkonjve. Pas pak, të dy partizanët u përqafuan me gjyshin dhe me Ilirin dhe u nisën. Njëri tërhiqte mushkën për kapistre, ndërsa tjetri mbante shokun e plagosur.

Kur u kthye në shtëpi, gjyshi i thirri Ilirit:

— Pa hajde këtu, mor nipçe! Hajde, mor kolopuç i gjyshit, se ma zbardhe faqen sonte. Po si të ra ndërmend, mor qerrata?! Bobo, do të na kishte shkuar nëpër duar ai trim e do të më mbetej peng në zemër gjersa të vdisja.

— E sheh, gjysh? Edhe gomari plak na hyri në punë! — i tha buzëgaz Iliri.

# NJE DITE NGA JETA E NJE DJALI

C'mendoni ju se ëndërronte atë mëngjez ai djalë, ndërsa ecte zbatohur në mes të shiut të ftohtë e të mërzitshëm? Ndoshta këpucë për të futur gishtérinjtë e vegjël, të enjtur e të skuqur nga të ftohtët, apo ndonjë dhomë të ngrohtë? Oh, jo, ai nuk shkonte aq larg... Djali ëndërronte që retë të shpërndaheshin dhe të linin rrezet e diellit t'i ngrohnin pak gjakun, që po i ngrinte në dejet e mpira e të mavijosura nga të ftohtët. Vetëm dielli, dielli... po ç'e do, retë e zeza e kishin mbuluar qiellin...

Ai ishte 13 vjeç. Në fytyrën e zbetë, dy sy të mëdhenj shikonin diku larg.

Djali e mbështolli më mirë pas trupit pallton e vet të grisur dhe u struk nën një pullaz, përballë shtëpisë së kryetarit të bashkisë. Tani, shiu i mërzitshëm nuk i binte më në trup. Shikonte me vëmendje pikat e tejdukshme të shitut, që binin nga pullazi dhe përziheshin me ujet e turbullt të rrëkesë. Zgjati pak dorën, dhe pikat i ranë mbi pëllëmbën e tij të vogël; pastaj mblodhi përsëri pas krahëve pallton e vet të vjetër dhe filloi të dridhej si një kallam i dobët buzë kënetës kur fryn era e tërbuar e marsit. Në trotuarin tjetër i shkuant sytë te një dyqan i vogël ku shiteshin gjëra të ngrohta të castit. Djali përcolli pështymën dhe u nis ngadalë për atje. Pas vitrinës së dyqanit pa duart trashaluqe, tërë pika të kuqe, të ustait, i cili rrotullonte qoftet dhe shishqebapet, që binin erë rigon. Djali mbështeti hundën në xhamin e vitrinës dhe shikoi me lakmi.

— Po sikur të m'i jepnin t'i haja të gjitha, a do të ngopesha vallë? — thoshte me vete. — Kushedi?!

Kapërceu përsëri pështymën dhe ndjeu një dhembje në bark. Ngadalë, si një hije, u fut në dyqan, u mbështet pas banakut dhe, nëpërmjet tymit që rrinte pezull si mjegull gri, shi-



kontakte fytyrat e klientëve, që pinin në qejfin e tyre. Njëri syresh, një burrë i trashë, që i shkëlqenin buzët nga yndyra e mëlcive të pjekura, i thirri një plaku çehrelimua, që mezi mbahej te një karrige në fund të dyqanit:

— O Nase! Pa kërce edhe një herë, për kokën tënde, se do të të jap dy grosh, — dhe nxori paratë nga xhepi.

Në fillim, plaku nuk u tund nga vendi, por, kur pa monedhat, u ngrit dhe filloi të kërcente duke kënduar me atë zërin e vet të mekur.

Djali shikonte me vëmendje kapotën e vjetër ushtarake të plakut, që dukej sikur e kishin shqyer qentë, dhe këmbët që i dridheshin. Kur pa se të gjithë ja kishin ngulur sytë plakut të shkretë, që kërcente nga zori për dy grosh, ndjeu një dhembshuri të madhe për atë të varfër. Ustai lëvizti nga vendi dhe rrrotulloi shish-qebapet. Djali ngriti sytë dhe shikoi me vëmendje një portret që varej në mur mbi kokën tullace të ustait. Ishte i mbretit, po djali nuk e njoihu pas xhamit të palarë të kornizës.

— Ky do të jetë babai i ustait ose kryetari i pianecëve, — mendoi djali, — ndryshe përsë ta varin këtu, në pijetore?

Pastaj e shikoi përsëri me dhembje plakun, që u mbështet i lodhur pas banakut duke i thënë atij burrit trashaluq:

— Nëmi paratë.

— Hidhu, hidhu, Nase! Pse, me dy tē rrotulluara do tē marrësh dy grosh?

Plaku mezi u tund nga vendi. Ishte zverdhur. Këmbët i dridhesin. Ai burri trashaluq u bë në qejf kur plaku ngriti duart dhe u bë gati tē kërcente. Atë çast, djali i tha plakut:

— Mos kërce, xhaxho, mos kërce, hajde tē dalim nga ky vend i fëlliqur.

Plaku e pa djalin me sy tē përlotur.

Burri trashaluq ja ngjeshi djalit me turshi pas qafe.

Klientët u gajasën.

Sa tē mbyllësh e tē hapësh sytë, djali rrëmbeu një shishe dhe ja flaku klientit.

Atë çast, një xhandar i shtrëngoi me forcë dorën e njomë e tē tretur dhe e mori me vete pér në xhandarmëri. Djali nuk kundërshtoi. Plaku e ndoqi pas.

Në xhandarmëri bënte ngrohtë. Djali sikur e mori veten. Xhandari e çoi te një oficer, që rrinte këmbë mbi këmbë pas një tavoline tē shtruuar me një xham tē zi tē shkëlqyer.

Xhandari i tha diçka në vesh oficerit tulac; ky u kthyte me inat nga djali dhe e pyeti me një zë tē çjerrë, si fishkëllima e ndonjë qerreje tē prishur:

— Si ta thonë emrin?

— Unë kam shumë emra, zoti oficer! — u përgjegj i qetë djali.

— Si, ke shumë emra?

— Po. Njëri më thërret qen, tjetri lypës, kurse ky xhandari më quajti rrugaç.

— Pusho! — i thirri me inat oficeri.

— Mirë, zoti oficer, do të pushoj, po as ti mos më ngacmo.

— Sa vjeç je?

— Nuk e mbaj mend. Kur më lindi nëna, zoti oficer, isha i vogël.

— Pusho, mistrec! Ke nënë?

— Jo.

— Po baba?

— Jo.

— S'i ke njohur prindërit kurrë?

— Mbaj mend njëherë një grua që më ledhatonte kokën dhe më tregonte përralla të bukura, po ajo vdiq nga veremi. Mbaj mend dhe një burrë që vinte në shtëpi i dehur dhe e rrihte atë grua, po ç'u bë, nuk e di. Mos e njihni gjë ju, zoti oficer?

— Me se jeton?

— Me ç'të gjej, zoti oficer.

— Dhe me ç'të vjedhësh.

— Jo, zoti oficer, nuk kam vjedhur kurrë.

Fitoj ndonjë lek duke mbajtur valixhet e udhëtarëve.

- Biruca do të të sjellë në vete, rrugaç!
- Pse më futni në birucë, zoti oficer?
- Qërohu! — ulëriti oficeri.

Djali mbështolli pas trupit pallton e vet të grisur dhe u largua duke lënë mbi dyshemenë e dhomës së oficerit gjurmët e këmbëve të tija tërë baltë. Xhandari e ndoqi pas. Pas ca ditësh, djalin e liruan. Ai ishte bërë koskë e lëkurë.

Kur doli në rrugë, trupi ju rrënqeth. Djali ngriti sytë nga qielli i murrmë dhe nisi përsëri të endej nëpër qytetin e lagur, pa u përzier me njeri. Pasi u lodh, u struk në fund të një rrugice, te një karrocë e prishur, dhe u mbulua kokë e këmbë me pallton e vet të vjetër. I kapitur siç ishte, ra në një gjumë të thellë. Pastaj buzëqeshi. I mjeri djalë! Vetëm në ëndërr mund të buzëqeshte...

# VIJAT E BARDHA

Nga maja e kodrës ku kishin hipur pionierët ekskursionistë, qyteti dukej si në pëllëm-bë të dorës. Ja sahati i madh, pallatet e larta dhe rrugët e drejta e të gjata, në të dy anët e të cilave mimozat kishin çelur mijëra topthetari, që përhapnin në ajër një erë të këndshme.

— Agron, e shikon atë vendin atje, te ajo rruga e gjerë ku njerëzit kalojnë si të vënëtë radhë, njëri pas tjetrit?

— Po, — ju përgjegj Agroni, që mundohej të gjente me sy që nga larg ndërtesen trekatshtetë shkollës.

— Ato janë vijat e bardha...

— E di, unë gjithnjë nëpër to kaloj.

— Tani edhe unë nëpër to kaloj, — tha Luli. — Kurrë nuk do t'i harroj ato vija të bardha,— tha ai, por aq ngadalë, saqë shoku, që kërkonte me sy ndërtesën e shkollës, nuk e dëgjoi. Atë çast, si në një ekran kinemaje, i doli përpara ngjarja.

... Ishte një ditë e ngrohtë maji. Mbi lulet shumëngjyrëshe endeshin fluturat dhe ble-tët punëtore. Luli doli nga shkolla me libra nën sqetull dhe u nis me ngut për në shtëpi, pa prioritasnjérin nga shokët e klasës. Ai mësonte mirë, po kurrë nuk i ndihmonte të tjerët. Kishinte nja dy shokë më të mëdhenj se veten në moshë, me të cilët luante vazhdimisht, kurse me moshatarët as që përzihej fare. Genci, një nga shokët e klasës, kur hynte Luli në oborr, thoshte:

«Pushoni dhe përkuluni, se arriti mendjemadhi». Dhe shokët, të rrjeshtuar, përkuleshin duke vënë buzën në gaz.

Pas fletërrufesë dhe mbledhjes që bënë përtë, e uli shumë hundën, po ende e mundonte sedra e sëmurë të futej në gjirin e kolektivit. U desh një ngjarje pothuaj e jashtëzakonshme që ai të kuptonte thellë se sa të drejta ishin kritikat e shokëve.

Një ditë, te kthesa e rrugës së shtëpisë e priste Bashkimi, një djalë i trashë e i shkurtër,

si trung mishi. Ai kishte vënë duart mbi timonin e bicikletës dhe rrinte kapardisur.

— Të pëlqen? — i tha ai kur Luli ju afrua dhe po e shikonte me vëmendje bicikletën e re.

— Po, e bukur është.

— Ma bleu babai.

— Edhe mua më tha babai se do të më blinte një bicikletë, po vetë nuk desha. Ç'e do bicikletën? Ajo të lodh këmbët. Të kesh motor, po...

— Zure të na shesësh mend tani. Ti gati sa s'qave kur Beni nuk ta dha bicikletën një xhiro.

— Atëhere po, kurse tani më ka dalë nga qejfi.

— Posi, — shtrembëroi turinjtë Bashkimi dhe u bë gati të nisej.

Luli e pa se po i shpëtonte bicikleta pa bërë xhiro, ndaj i tha shokut:

— Bashkim, të kam gjetur katër lloj pullash që ti nuk i ke.

— Kur të vi t'i marr?

— Që sot.

— Sa shok i mirë që je ti, Luli! Na, bëje një xhiro me bicikletë, provoje njëherë në ecën mirë, apo jo.

— Mirë, po e provoj, — tha Luli duke ja lënë Bashkimit librat e shkollës.

Luli filloi të tregonte zotësinë e vet përpara kalimtarëve duke bërë dredha përpara maqinave.

— Ç'bën ashtu, mor djalë? Do të thyesh kokën, — i tha një grua.

— Mos ki merak, teto, unë jam çiklist i kategorisë së parë, — tha dhe hoqi duart nga timoni, duke e mbajtur trupin drejt. Por, atë çast, shkau goma, dhe Luli ra përmbyss në troutar.

— Ama, çiklist i kategorisë së parë! — buzëqeshi një vogëlushe leshverdhë, që po kalonte aty pranë duke mbajtur dorën te dy cepat e shallit të kuq.

— Luli, u vrave?

— Jo, ore, pak fare, — mërmëriti ai duke fshirë pluhurin nga rrobat.

— Shiko si qenka prishur bicikleta!

— Pse, e prishur quhet kur i cifloset pak boja? Pasdite, kur të vish të marrësh pullat, i vë unë një çikë bojë speciale, dhe rregullohet përbukuri. Drekën e mirë! Pasdreke të pres në shtëpi.

— Drekën e mirë! — ja ktheu Bashkimi me gjysmë zëri.

Luli mori udhën për në shtëpi. Rrugës

shikonte kalimtarët, që shkonin midis vijave të bardha, dhe qeshte me vete:

«Sa budallenj që janë! Nuk kalojnë këtu, që t'i bien më shkurt. E ç'janë vijat e bardha? Mësuesi na tha njëherë: Kalimi nëpër vijat e bardha bën që të mos ngjasin aksidente. Fjalë boshe!»

Luli kaloi me shpejtësi në trotuarin tjetër duke i rënë me këmbë një guri, si të ishte top llastiku. Së largu u dëgjua zëri i pandërprerë i burisë së një maqine që po vinte me shpejtësi drejt kthesës. Luli u afrua buzë trotuarit dhe priti.

«Sa të afrohet, do të nisem me vrap për në trotuarin tjetër; të shohim se kush është më i shpejtë!» — mendoi ai me vete dhe u hodhi një sy vijave të bardha, cepi i të cilave dukej pas kthesës, nja 30 metra larg vendit ku kishte qëndruar ai vetë. Maqina po afrohej me shpejtësi. Në çast, Luli vrapoi me vrull fare pranë maqinës. Shoferi frenoi dhe e ktheu me forcë timonin nga e djathta. Nga forca, koka ju përplas në pjesën e prapme të mbulojës së kabinës. Luli, i përbysur dhe i trembur, u ngrit dhe ja dha vrapit për në shtëpi me sa i hanin këmbët. Dridhej i téri. Pantallonat i qenë çarë gjëri në fund. Duke vrapuar, veshi i kapi këto zëra:



— Sa djalë i pabindur, bën lojëra të rrezikshme mu në mes të rrugës!

— Kur nuk e zura dot, pa do t'ja bëja kurrizin më të butë se barkun, — foli një tjetër, që mundohej të sillte në vete shoferin.

Atë natë Luli nuk fjeti. Vërtitej në krevat si peshku në zall dhe pëshpëriste me vete: «Shyqyr që nuk më njohu njeri!»

Në mëngjez nuk hëngri gjë; vuri pak bukë në xhep dhe u nis për në shkollë. Që nga larg dëgjoi zilen e shkollës. Vrapoi e u rrjeshtua me shokët dhe u fut në klasë.

Kur mësuesi po bënte apelin, trokiti dera dhe hyri Iliri, një djalë thatim, syzi, që kurrë nuk grindej me shokët. Në të gjitha lëndët, përveç matematikës, ai mirrte nota shumë të mira. Meqë kishte munguar për një kohë të gjatë kur ishte sëmurë, e kishte vështirë t'i arrinte shokët.

— Mirëmëngjezi!

— Mirëmëngjezi, Ilir! Përse u vonove? — e pyeti mësuesi me zë të ëmbël.

— Isha me nënën në spital, te babai; është plagosur në kokë.

— Po si i ndodhi? — pyeti me keqardhje mësuesi duke ju afruar Ilirit.

— Na thanë se një djalë deshi të kalonte me vrap përpara maqinës, ndërsa babai po e

ngiste me shpejtësi, sepse po çonte një grua në spital. Djali dhe gruaja shpëtuan, vetëm babai u plagos në kokë. Sot do ta operojnë.

- Po kush qe ai djalë?
- Nuk e dimë, se iku me vrap.
- Për fat të keq, rrugaçë të tillë ka ende,
- tha mësuesi me inat. — Ti, Ilir, kur të duash, shko te babai, ke leje nga unë.
- Faleminderit! — tha Iliri dhe u ul në bangë.

Lulit i kishte rënë në fytyrë një çehre e verdhë; ballin e kishte mbështetur mbi dorë dhe bënte sikur shikonte fletoren e detyrate. Zemra i rrihte me forcë, dhe nuk kishte guxim as të kthente kokën nga banga e Ilirit.

«Po sikur babai i Ilirit të vdesë? Jo, jo! — pëshpëriti me vete. — Ai më mori atëhere në maqinë, është i fortë. Ai udhëton natë e ditë mbi rrugët malore, në shi, në dëborë e në tu-fan».

Mezi priti sa të mbaronte mësimi dhe, kokulur, u nis për në shtëpi. Ndenji në këndin e vet mbi një libër gjer në të perënduar të dieillit. Pastaj i tha nënës:

— Nënë, më jep pesë lekë; më duhet të blej diçka.

Nëna ja dha paratë, dhe Luli, kokulur, bëri për nga dera. Giunjët i dridheshin. Te

pragu i derës u duk se u pendua, rrrotulloi një herë kartmonedhën në dorë, dhe i thirri në-nës me gjysmë zëri:

- Nënë!
- E, mor bir, ç'ke, s'të dalin paratë?
- Më dalin, nënë, më dalin, po a e di pse i dua paratë?
- Ti the se do të bleje diçka.
- Do të blej diçka dhe do të shkoj në spital, te babai i një shokut tim, Ilirit.
- Po nga se vuan babai i shokut tënd?
- Unë e kam fajin, nënë! — i tha Luli me gjysmë zëri.
- Ti?! Pse!? Pa tregoi nënës!

Ai mbështeti fytyrën në prehrin e nënës, e cila e la çorapen përgjysmë. Duke qarë me dënesë, ai i tregoi gjithshka. Kur Luli mbaroi së treguari, nëna nuk foli, po u ngrit, u vesh dhe u bë gati të dilte.

— Po ti, nënë, ku do të shkosh? — pyeti Luli duke fshirë sytë e skuqur.

— Do të shkojmë bashkë te babai i Ilirit. Luli uli kokën dhe shkoi pas së ëmës.

Rrugët gumëzhanin. Te dyqani i frutave, mu afër shtëpisë, nëna e Lulit bleu një kile rrush të zi frigoriferi. Pa folur, hipën në autobus dhe u nisën për në spital.

— Ku do të shkoni? — i pyeti roja i spi-

talit, një bablok, që po thithte një çibuk të trashë.

— Duam të takojmë pak atë shoferin që u plagos dje, — i tha nëna e Lulit.

— Mirë, futuni te ai pavioni atje.

Në një krevat pranë dritares, Luli pa Ilin, që po rrinte pranë të atit kokëlidhur; ky seç po i tregonte.

Babai e preu bisedën dhe, duke parë nga dera, i tha Ilirit gjithë gëzim:

— Shiko, shiko, Luli paska ardhur të më shikojë!

Me të dëgjuar këto fjalë, Luli shtangu në vend. Rushi sa s'i ra nga duart. S'dinte si të bënte. Donte t'i hidhej në qafë, po s'kishte guxim.

Eëma, e tronditur dhe ajo, e mori veten më shpejt.

— Shko, bir, shko, kërkoji falje!

Luli nuk u mbajt më; e la rrushin mbi komodinë dhe u hodh në krahët e të sëmurit.

— Më fal, xha Petro, më fal! Unë isha ai djali që deshi ta kalonte maqinën.

Petrua nuk foli, veçse e shtrëngoi në gji.

Nëna e Lulit ju afrua ngadalë shtratit të të sëmurit dhe tha me zë të ulët:

— Ai ka bërë një faj të madh... Jam nëna e tij.

— Po, është e vërtetë se ka bërë një faj të rрендë, po ai nuk do ta përsërisë më kurrë.

— Ju jap fjalën e pionierit! — thirri Luli me lot në sy.

Nëna filloi ta pyeste të sëmurin për shëndetin, ndërsa Luli dhe Iliri dëgjonin dhe, herëherë, shihnin njëri tjetrin në sy. Me vështrimin e vet të çiltër, Iliri kërkonte ta ngushëllonte shokun që kishte gabuar.

Pas pak, nëna u ngrit, i shtrëngoi dorën të sëmurit duke i thënë:

— Sapo të dilni, të na urdhëroni nga shtëpia.

— Do të vi patjetër. Kur të bëj udhëtimin e parë, do t'i marr në maqinë Lulin dhe Ilirin.

Luli e përoqafoi përsëri të sëmurin dhe, bashkë me nënën dhe Ilirin, u nisën për në shtëpi.

Iliri nuk i tregoi asnjeriut për atë që ndodhi. Që atë ditë, Luli dhe Iliri filluan të mësonin bashkë. Luli nuk u nda më kurrë nga shokët e klasës...

— E gjeta, e gjetë, ja ku është shkolla! — thirri i gëzuar Iliri.

Luli u përmend.

— Po, po, tanë e shikoj dhë unë, sa bukur që duket!

Pas pak, së bashku me shokët dhe mësuesin, zbritën në rrugën e asfaltuar duke kënduar.

# FIDANET E MOLLEVE

Lanti mori jorganin në krahë, u afrua te dritarja, mbështeti hundën e vogël mbi xhamin e ftohtë dhe vështroi përjashta. Pranvera sapo kishte ardhur. Dëbora po shkrihej, dhe bari i butë e plot lëng kishte buisur në lëndinat dhe anës arave të mbjella me grurë. Te bregu ai dalloi ca njolla të mëdha ngjyrë kafe, që rrëthoheshin nga gjelbërimi i barit. «Janë gropat ku do të mbjellim fidanet e mollëve,» — tha me vete duke fshirë më mirë me dorë perden e avullit që po vishte krejt xhamin e drithares, dhe ju kthyen nënës, që dukej nga dera gjysmë e hapur tek përgatiste mëngjezin:

— Sa është ora, moj nënë?

— Gjashtë.

— Çudi, si nuk erdhi ky Gëzimi; do ta ketë zënë gjumi.

— Është ende shpejt, mor bir.

Lanti nuk u përgjegj. Palosi jorganin, e futi në musandër dhe doli të lahej. Ujët e freskët ja skuqi fytyrën e hollë e pak të zgjatur. Kaloi nja dy herë në flokët e verdhë dorën e lagur dhe u fut brenda. Si hëngri mëngjezin, doli në udhë.

Bagëtia po zbriste me turfullimë për në lëndinat matanë pérroit. Nga zilkat e tyre kumbonte tërë fshati.

S'kishte bërë as dhjetë hapa, kur dalloj Gëzimin, që po vinte kaluar mbi Kuqon, kalin më të bukur të kooperativës, dhe këndonte këngën e qengjit të vogël.

— Eheee... o Gëzim! — thirri Lanti duke vënë dorën anës gojës, për të mbledhur më mirë zérin. — Zbrit nga ana e pérroit.

Gëzimi ktheu Kuqon duke ja rrahu lehtë qafën e mbuluar nga jelet e zeza, që vetëtinin.

Lanti zbriti tatëpjetë me vrap. Herë-herë ndalonte për një çast që të rregullonte rripin e lirë të sandales, e cila i dilte nga këmba.

— Mirëmëngjezi, Gëzim! Kujtova se të kishte zënë gjumi.

— Jam ngritur që me natë, po mezi e rregullova kalin, se gjyshi nuk është në shtëpi.

Ai ka shkuar që mbrëmë në qytet, në mbledhjen e bujqve të dalluar. — Ndërkokë, Gëzimi afroi kalin pranë një guri të madh buzë rru-gës dhe thirri: — Hidhu, Lanti!

Lanti vuri duart pranë samarit dhe u hodh mbi të. Kali u lëkund pak, turfulloj duke tundur kokën; tringëllima melodioze e zilkave dhe karkaleve u përhap gjer larg. Pastaj u nis me vrap, me hap të sigurtë, si ushtar i vjetër dhe i stërvitur.

— Lanti, a e more autorizimin përfidane?

— Ja ku e kam, ma dha dje mësuesja e botanikës.

— Ama, sa qejf do të jetë kur mollët të mbushen me lule dhe pastaj me kokrra plot lëng të émbël!

— Do të zënë të gjitha fidanet, vallë? — pyeti Lanti.

— Asnjë nuk do të na vejë dëm; do t'i mbjellim me kujdes. Pastaj, atje do të jetë dhe agronomi i kooperativës, babai i Taqit; vetë u zotua atë ditë në mbledhjen e prindërve. Atje do të jetë dhe mësuesja e botanikës. E di sa merr vesh ajo nga pemët! Njëherë, kur po shkoni përfidane marrë pleh në mal, te shpellat ku verojnë dhentë, disa fshatarë po mbillnin te ajo zallishtja buzë përroit ca fidane fiqsh. «Mos

i mbillni këtu fidanet e fiqve, — u tha mësues-ja. — Ky vend nuk bën pér to».

— «Jemi të vjetër ne pér këto punë, moj zonjushe, e dimë mirë zanatin! — ja kthyen ata».

Por, pas disa javësh, fidanet u thanë.

Kishin ecur ndonjë orë, kur Lanti thirri:

— Ej, Kuqo, ndalu, vëlla, ndalu, se u af-ruam te lumi.

Djemtë u hodhën nga kali, e tërhoqën pér kapistre dhe e kaluan me kujdes lumin, që sa vinte e dukej sikur fryhej, dhe hipën përséri mbi samarin e gjerë të Kuqos, që shkundej pér t'u tharë. Pas pak, ata ja nisën këngës, kur-se Kuqua vrapit, duke lënë pas shtëllunga pluhuri. Kur arritën në fidanishten e fermës, djemtë u hodhën nga kali dhe shkuant te roja plak, që po gdhendte një shkop thane.

— Mirëdita, xhaxho!

Plaku i shkurtër, topolak, i vështroi djemtë nga koka, gjer te këmbët. Pastaj u tha:

— Mirëdita, more djem, ç'ju solli këndej nga ne?

— Erdhëm të marrim fidanet e mollëve.

— Fidanet e mollëve? Hëm... po e keni autorizimin?

— Urdhëro! — i tha Lanti dhe ja vuri në dorë.

Plaku nxori gjyslyket, e lexoi dhe u nis; djemtë i shkuant pas.

— Ja ku janë, — u tha plaku. — Mbajini me kujdes, se janë mollë për kokën e mollëve.

— Mos u bëj merak, xhaxho, — i tha Lanti.

Djemtë ja ngarkuan fidanet Kuqos, u përshtëndetën me plakun dhe u nisën. Kuqua përpara dhe ata pas.

— Të nxitojmë, Lanti, se po na prishet keq koha.

Djemtë nganë kalin dhe nisën të ecnin më me nxitim.

Qielli u ngrys nga të katër anët. Era përkulte plepat e njomë, që dukeshin si hije të fryra në mugëtirën e mbrëmjes. Zhurma e erës përzihej me buçimën e ujit të lumit, që përplasej te shpellat gushëbardha. Gëzimi ndali kalin pranë lumit dhe i tha shokut:

— Sa qenka fryrë, mor Lanti! Dhe vjen me rrëmbim. E kalojmë dot, vallë?!

— Gëzim, — ja ktheu Lanti, — prit të lidhem bashkë për mezi me rrip. Unë po eci përpara, ti shtrëngajoje mirë kapistrën e kalit.

Ashtu bënë. Uji i ftohtë, që të ngjethëte mishtë, përplasej te kofshët e djemve. Furia e lumit po shtohej nga çasti në çast. Rripi u zgjidh, dhe djemtë u ndanë nga njëri-tjetri.

Gëzimi ndjeu ta tërhiqte një forcë e madhe dhe ju muarën mendtë.

— Lanti! Kuqua, fidanet! — thirri i tmerruar Gëzimi.

Lanti u kthye me mundim dhe u vuri krahët fidaneve. Gëzimi nisi ta tërhiqte përsëri Kuqon për kapistre duke i thirrur:

— Ngrehu, Kuqo, forca... forca, Kuqo... forca!

Kur Kuqua u ngrit, Lantit i shkau këmba dhe u zhyt në ujë.

— Lanti! — klithi Gëzimi.

Lanti u ngrit dhe filloi të notonte me mundim. Kur dolën në breg, Lanti, Gëzimi dhe Kuqua u shtrinë të këputur mbi rërë. Askush nuk fliste; dëgjohej vetëm zhurma e lumi. Tani s'i trembeshin më. Djemtë dridheshin. Buzët u ishin mavijosur. Tej, nga lindja, vetëtinte dhe gjëmonte.

— Lanti, si je? — pyeti Gëzimi duke ngri-  
tur pak kokën.

— Më dhemb këmba, — u përgjegj ai,  
ashtu siç qe, me ballin të mbështetur mbi dorë.

— Po Kuqua si është?

— Mirë më duket, po i hap dhe i mbyll  
ngadalë sytë.

— Fidanet, mos u prishën fidanet?



— Jo, jo, — ja ktheu Gëzimi. — Kashta i ka mbrojtur përmrekulli.

Lanti provoi të ngrihej duke u mbajtur pas Gëzimit, po ishte e kotë. Këmba e ndrydhur i dhimbte.

— Lanti, ulu pak këtu të ta tërheq, se mbbase vete në vend.

— Mirë. . . o. . . ngadalë, Gëzim!

— Duro dhe ca.

— Lërmë mua; ngrije Kuqon dhe shkoni; fidanet mund të na prishen. Unë nuk kam frikë të rri vetëm këtu. Fidanet duhen çuar në fshat pa u prishur, kemi dhënë fjalën.

— Jo, nuk të le vetëm! — i tha Gëzimi dhe shkoi pranë kalit, që kishte mbështetur kokën mbi bar, dhe i thirri:

— Kuqo, ngreu, xhan!

Kali ngriti kokën, e pa me ata sytë e vet të mëdhenj, që tregonin dhembje, dhe u ngrit më këmbë me mundim të madh. Gjurin e kishte të gjakosur. Kur nisi t'ja lidhte me shaminë e vet të pastër, Gëzimi ndjeu në qafë frymën e ngrohtë të Kuqos, që kishte afruar kokën mbi kaçurrelat e tija të zesa. Djali e përqafroi dhe e tërhoqi ngadalë drejt pemës ku ishte mbështetur Lanti. Fidanet e mollëve nuk kishin pësuar gjë.

— Dëgjo, Gëzim, shko dalëngadalë me

Kuqon në fshat. Unë po rri këtu; shko, mos u bëj shok i keq.

— Jo, Lanti, nuk të lë vetëm. Pastaj, pa shiko Kuqon; është dërmuar. Sikur të rrëzohet, unë nuk e ngre dot.

— Gëzim, po do të na prishen fidanet. Shokët do të tallen pastaj me ne; bregu do të mbetet pa u mbjellur.

— Jo, nuk prishen.

Për një çast, djemtë heshtën.

Nata zbriti e ftohtë dhe e errët. Në qiel nuk kishte as hënë, as yje. Gëzimi mezi mundi ta ndizte një fije shkrepse dhe e vuri poshtë ca karthijave të thata. Ato nisën të kërcisin si petë të pjekura. Pas pak, flaka e kuqe bubuloi. Djemtë filluan të ngroheshin.

— Ke ftohtë, Gëzim?

— Pak. Po ty, të dhemb këmba?

— Eë. . .

— Lanti, ç'bëjnë tani shokët, vallë?

— Ndoshta na presin te Goria e Madhe.

— Vërtet? Me ta mund të jetë dhe mësuesja e botanikës. Sa do të shqetësohet ajo përvonesën tonë!

— Gëzim, — thirri papritur Lanti, — a e shikon atë dritën atje? Ç'të jetë, vallë?

— Kushedi.

— Shiko si tundet. Tani u bënë dy.

— Dëgjohen zëra dhe një zile  
— Mbaj vesh, ata po thërrasin.  
— Ehe... O Lanti... O Gëzim, ku jeni  
moreee... ehe...

— Shokët! — thanë djemtë, të dy njëherësh. Zemrat u rrighthin me forcë. Nga gëzimi, nuk kishin fuqi të thërrisnin. Së fundi, Gëzimi bëri një çap përpara, vuri duart anës gojës dhe thirri:

— Këtu, këtu jemi, pranë lumit.  
— I gjetëm, — u dëgjua një zë.

Hijet e njerëzve dhe fenerët filluan të lëviznin më shpejt për nga djemtë. Kuqua nisi të hingëllinte i gëzuar, sikur e ndjeu atrimin e shokëve. Zilja dhe fenerët që po afroheshin, dukej sikur largonin errësirën.

Lanti dalloj që nga larg fytyrën e Benit, shokut të tyre, që mbante në dorë fenerin dhe tërhiqte pas një mushkë. Ai thirri:

— Janë ata, shokët, shokët!

Gëzimi u doli përpara. Ata e përqafuan fort.

Pastaj, shokët dhe mësuesja e botanikës shkuant te Lanti, që buzëqeshte i kënaqur, mbështetur te trungu i një rrapi të mocëm. Titi me Luanin e ngritën dhe e vunë mbi mushkë. Në mushkë ngarkuan dhe fidanet e mollë-

ve dhe u nisën për në fshat. Në mes tyre ecte çalë-çalë dhe Kuqua, me këmbë të lidhur.

Të nesërmen, kur syri gazmor i diellit do-li nga majë e malit, te bregu valavitej një flamur i kuq; ziente puna, gjëmonte kënga. Fëmijët mbillnin me kujdes fidanet në gropat e rregullta, ndërsa era ledhatonte fytyrat e tyre ngjyrë gruri dhe përkundte fidanet e porsa mbjella.

# DY SHOKE

Xhimi dhe Roberti jetonin në fund të lagjes së varfër të zezakëve. Kasollja e tyre ishte e mbuluar me letër katrama. Në dritare, në vend të xhamit, kishin vënë letër të trashë reklame, shumë të vjetëruar. Xhimi kishte mbetur jetim dhe e mbante e ëma e Robertit. Ajo punonte në shtëpinë e një pasaniku; lante rroba.

Xhimi dhe Roberti nuk ziheshin kurrë; mjerimi i kishte lidhur në një miqësi të tillë, që s'kishte forcë ta thyente. Një ditë, e ëma e Robertit u rrëzua nga shkallët e shtëpisë së zotnisë. E shpunë në spital. Kur doli, e këshilluan të mos punonte për një kohë të gjatë. Duhej

të kurohej në llixha, po ku t'i gjente të hollat?

Në shtëpi kishte vetëm disa lecka të vjetra, tri lugë me bisht të thyer dhe disa tasa balte me buzë të plasaritura, si buzët e këtyre njerëzve të cfilitur nga jeta. Që atë ditë, lodrat,ën-dërrat e tyre fëminore u bënë edhe më të zymta. Ata kërkonin punë, po s'ishte gjë e lehtë të gjenin.

Një ditë, Xhimi thirri që jashtë me gëzim:

— Nënë, — kështu i thërriste edhe ai nënës së Robertit, — gjeta punë; më rregulloi një mik i vjetër i babait të shes gazeta.

Eëma e Robertit mbushi sytë me lot dhe e puthi në ballë.

Edhe Robertit i gjeti punë xhaxhai: të shtynte vagonat në minierën e qomyrgurit.

Në mëngjez, që të dy u ngritën herët, sapo drita hyri nëpër të çarat e kartonit që mbyllte dritaren. Ngjen bukën e thekrës në një tas me kafe surugato, muarën bekimin e nënës dhe u nisën. Nëna, që mezi ishte ngritur, u mbështet te praku i derës dhe i ndoqi me sy fëmijët, që fluturonin këmbëzbathur në rrugicën e ngushtë.

— Robert, paratë që do të marrim, do t'i ruajmë sa të çojmë nënën në llixha.

Xhimi e përqafroi fort Robertin, u puthën

dhe u ndanë duke e përshëndetur nga larg njëri-tjetrin.

Xhimi mori tufën e gazetave dhe iku me nxitim.

— Gazeta e sotme... urdhëroni, — dhe shkelte mbi asfaltin e lagur ku pasqyroheshin ndërtesat e larta si thikë, me majë nga qelli ngjyrë blu.

Xhimi vazhdonte të thërriste:

— Gazeta e sotme... Ushtarë të tjerë amerikanë nisen për në Vietnam. Gazeta e sotme... Presidenti shtroi një darkë madhështore; priti dhëndërrin dhe vajzën e vet.

Njerëz me fytyra të vrejtura, punëtorë të veshur me rroba pune, hamej që prisnin dikë të thërriste për të mbartur ndonjë plaçkë, zonja të pispilosura që tërhiqnin kone të vogla lesh-tore, i lëshonin monedhën në dorë, dhe Xhimi u jepte gazeten duke buzëqeshur nga halli.

Xhimi i shikonte monedhat dhe fuste në xhep «thesarin» që do të dorëzonte në mbrëmje te sipërmarrësi fytyrëngrysur, që thithë vazhdimisht puron e trashë. Dhe, nga gjithë ai thesar, do të mirrte vetëm një pjesë fare të vogël dhe një të rrahur ledhatues në faqe.

Robert me xhaxhanë zbritën në galeritë e errëta e plot lagështi të minierës. Në fillim, Ro-

bertin e kapi një frikë, ju duk sikur ju zu fryma, po shpejt e mori veten. Minatorët, me buzët të nxira, e pritën mirë. Njëri syresh, një djalosh i shkathët, thatim, me një sy xhami, i tregoi punën.

— Këtë vagon me qymyr do ta zbrazësh atje në fund. Ki kujdes, mos e rrëzosh në mes të rrugës, se mbikqyrësi të zhdëp në dru, të nxjerr nga puna dhe s'të paguan asnë grosh. Kështu, Roberti filloi të punonte. Në fillim vagonin e shtynte mirë; minatorët qeshnin kur e shikonin që vinte me një frymë. Po krahët e tij të njomë u lodhën shpejt. Vagoni i mbushur me qymyr të zi, si zemra e pasanikëve, i dukej gjithnjë e më i rëndë. I dukej sikur lëvizte dhe llamba elektrike, po ai vazhdonte të shtynte vagonin dhe mendonte: «Kushedi ç'bën Xhimi tani? Ai, të paktën, është mbi tokë».

Minutat nuk ecnin. Fuqitë po e linin. Qe nxirë i téri me qymyr, dhe vetëm të bardhët e syve i dukeshin si dy margaritarë të ndritshëm:

«Mos jam sëmurë?» — mendoi ai dhe vuri në ballë dorën e ndotur. — Jo, jo!» — dhe ju kujtua se e kishte marrë uria.

Pështatu përtokë dhe vazhdoi të shtynte vagonin në shinat e ftohta.

Kur doli nga miniera, ora ra pesë. Mori frymë thellë dhe u nis ngadalë për në shtëpi. Te hyrja e shtëpisë pa një grumbull njerëzish.

«Diçka do t'i ketë ndodhur nënës,» — tha me vete dhe vrapoi drejt turmës. U fut me vrap në shtëpi dhe pa nënën, që rrinte pranë krevatit të vjetër prej dërrase të Xhimit.

Koka e Xhimit, e lidhur me një fasho të bardhë të gjakosur, dukej si një lule e përthyer nga stuhiat.

— Xhim! Vëlla! — thirri Roberti dhe u hodh pranë shtratit.

Xhimi nuk përmendej.

— Po si i ndodhi, moj nënë, si i ndodhi?

— pyeti Roberti duke jū dridhur buza.

— Xhimi donte të shiste sa më shumë gazeta, — foli një burrë që rrinte pranë nënës, — ndryshe sipërmarrësi e zbonte nga puna. Brodhi tërë qytetin. Në një rrugë të ngushtë pa një veturë luksoze, që shkonte nga njëri cep i rrugës, në tjetrin. Shoferi, një djalë pasanik, i përkëdhelur, tekanjoz, deshi ta trembte Xhimin dhe i vajti pranë me veturë. Mirëpo nuk i mbajti dot frenat dhe...

— Ah, i poshtri! — thirri Roberti duke shtrënguar në dorë çarçafin e Xhimit, të përlyer me gjak. — Xhim, çou vëlla, çou, do ta marrim hakun.



Xhimi hapi sytë dhe mërmëriti i lodhur:

— S'patëm fat ta çonim nënën në llixha, Robert, as të blinim. . . — Dhe s'e mbaroi dot fjalën. . .

— Xhim! Xhim! Ti do të shërohesh. Unë do të punoj sa për tre. Nuk të vjen keq të ndahesh nga unë, folë. . . Xhim!

Po shoku s'foli më. . .

**BIBLIOTEKA E SHIETIT**  
**GJIROKASTER**
48862
  
**TRYEZA E LËNDES**

Dikush u fut në pyll .....	3
«Krushqit» .....	14
Amaneti i partizanit të plagosur .....	23
Karroca gazmore .....	32
Kulla e beut .....	40
Fredi niset për në mal .....	47
Dredhia e Ilirit .....	56
Një ditë ngajeta e një djali .....	64
Vijat e bardha .....	71
Fidanet e mollëve .....	82
Dy shokë .....	93